



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 693 Akti

**Nr. 686 Vendimi
Tiranë, më 14.7.2023**

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

| | |
|---------------------------|-----------|
| Genta Tafa (Bungo) | Kryesuese |
| Roland Ilia | Relator |
| Suela Zhegu | Anëtare |

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 14.7.2023, ora 10:30, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Z. Xhelian Seferi, me detyrë Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Xhelian Seferi, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Xhelian Seferi, me detyrë Prokuror pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).
3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka hedhur shortin në muajin Dhjetor të vitit 2020, në përfundim të të cilit rezultoi që, subjekti i rivlerësimit Xhelian Seferi do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Suela Zhegu. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Roland Ilia. Ndërsa kryesuese e trupit gjykues u caktua me mirëkuptim, komisionere Genta Tafa. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Më pas u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Xhelian Seferi, sipas nenit 45 të ligjit 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve e rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.
4. Subjektit të rivlerësimit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për tu shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
5. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tre kriteret e vlerësimit: të pasurisë, të kontrollit të figurës, si dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.
6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pas përfundimit të hetimit të thelluar administrativ për të tria kriteret e vlerësimit - vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, në datën 4.7.2023, vendosi (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Xhelian Seferi; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
7. Subjekti i rivlerësimit pas njoftimit mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja, të cilat i paraqiti në rrugë zyrtare pranë Komisionit më datë 12.7.2023.
8. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim dhe i analizoi shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, vendosi të ftojë z. Xhelian Seferi në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Subjekti i rivlerësimit Xhelian Seferi u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 12.7.2023.

16. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 14.7.2023, ora 10:30, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

17. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Xhelian Seferi kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Z. Xhelian Seferi ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikmëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

20.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-u është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë

¹“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit

kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore të dorëzuara ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-u;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

23. Bazuar në ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në ligjin nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave përfundoi kontrollin e plotë të deklaratës së pasurisë dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, konstatohet se për subjektin Xhelian Seferi:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklaram të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

24. Xhelian Seferi është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2011, dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar, ndër vite, deklaratat e interesave private: (i) para fillimit të detyrës, vitit 2011; (ii) periodike/vjetore, për vitet 2012-2016; (iii) deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, për efekt të ligjit nr. 84/2016.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

25. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në

të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

analizë provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; deklaratimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

26. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklarimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Xhelian Seferi, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, me nr. indeksi ***, datë 26.1.2017, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2012 – 2016, në raport me të dhënat në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit Xhelian Seferi ka deklaruar pasuritë si vijojnë:

1. Automjet

1.1 Subjekti ka deklaruar Automjet tip “ ****” me targa AA ***, blerë me kontratën noteriale dt. 9.12.2016. Vlera 4.500 euro. Pjesa takuese 100%.

1.2 Burim për blerjen e kësaj pasurie janë deklaruar kursimet ndër vite dhe shitja e automjetit tip “****”.

Hetimi i kryer nga Komisioni

1.3 DPSHTRR², ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka në pronësi automjetin me targë AA***, blerë me kontratë shitblerje, më datë 9.12.2016, me palë shitëse T.A., kundrejt vlerës 4,500 euro.

1.4 Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka blerë këtë automjet të llojit automjet ***, vit prodhimi 2004, me targë AA*** me kontratë shitblerje automjeti me nr.*** rep. nr.*** kol., datë 9.12.2016. Vlera sipas kontratës është në shumën 4,500 euro, shumë e cila është likuiduar plotësisht para redaktimit të kontratës, jashtë zyrës noteriale.

1.5 Me shkresën e datës 17.3.2023 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së parë Elbasan dhe shkresën e datës 20.3.2023 Prokuroria pranë Gjykatës së shkallës së parë Tiranë, konfirmon se, subjekti i rivlerësimit nuk ka ndjekur ndonjë çështje penale me palën shitëse të pasurisë automjet tip ***, shtetasin T.A.

² Shiko pergjigjet e DPSHTRR ne dosjen e Komisionit dhe ILDKPKI

1.6 Lidhur me burimin e blerjes së kësaj pasurie në deklaratën vetting subjekti ka deklaruar kursimet ndër vite dhe të ardhura nga shitja e automjetit tip *** në vitin 2016.

1.7 Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2016 subjekti ka deklaruar; *“Blerë automjet tip *** me targa AA *** me kontratën nr. *** rep, nr. *** kol. dt. 09.12.2016. – 4,500 euro – Automjeti është blerë me të ardhurat e siguruara nga shitja e automjetit tip ***, kursimet ndër vite të deklaruara në deklaratat e mëparshme vjetore të pasurisë si dhe nga të ardhurat nga paga ime dhe bashkëshortes përgjatë vitit 2016”*. Në këtë deklaratë periodike subjekti ka shtuar si burim dhe të ardhurat e tij dhe bashkëshortes për vitin 2016.

a. Lidhur me burimin për të ardhurat nga shitja e pasurisë autoveturë tip ***

1.8 Bazuar në kontratën e shitblerjes së automjetit nr.*** rep. nr.*** kol. datë 21.1.2016, subjekti Xhelian Seferi i ka shitur shtetasit O.H. automjetin ***, vit prodhimi 2003, kundrejt vlerës 1,500 euro. Sipas kësaj kontrate, vlera e shit-blerjes është likuiduar plotësisht nga blerësi, jashtë zyrës noteriale.

1.9 Rezultoi se, automjetin tip *** subjekti e ka blerë me kontratë shitblerje nr.*** rep., nr.*** kol., datë 9.5.2013, në vlerën 300 euro nga shtetasi italian A.L.C.

1.10 Lidhur me këtë automjet tip ***, vlerën e blerjes, pagimin e detyrimeve tatimore dhe marrëdhëniet apo ndonjë konflikt të mundshëm interesi me palën shitëse, Komisioni hetoi më tej duke pyetur dhe subjektin e rivlerësimit.

1.11 Në përgjigje të pyetsorit nr.*** subjekti deklaroi se, *është e vërtetë fakti që mjetin tip *** e kam blerë në vitin 2013 në vlerën 300 euro nga shtetasi italian A. L.C me Kontratë shitblerje Nr. *** rep, nr. *** kol, dt.09.05.2013. Mjeti nuk kishte të paguar detyrimet doganore në Republikën e Shqipërisë, pra nuk ishte i zhdoganuar. Në mjetin e mësipërm kam kryer shpenzime si: 1. Zhdoganim, 2. Regjistrim dhe targim mjeti dhe 3. Riparim i impinantit të gazit (LPG). Disponoj faturën e zhdoganimit të mjetit në datë 27.02.2014 të cilën po jua bashkalidh si provë. Nuk disponoj faturë për riparimin e impiantit e gazit, për shkak të kohës që ka kaluar, por ka qënë afërsisht 450 euro. Nuk është paguar tatim fitimi nga shitja e mjetit tip ***, pasi së pari kam menduar se vlera e blerjes dhe vlera e shitjes kanë qënë në të njëjtin nivel, duke llogaritur dhe shpenzimet e bëra për mjetin, dhe unë nuk kam fituar nga kjo shitje. Së dyti, unë nuk kam qënë asnjëherë subjekt që ushtrioja aktivitet fitimprurës që të krijoja fitim nga shitja e mjetit”*.

1.12 Bazuar në shkresën e datës 17.3.2023 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe shkresës së datës 20.3.2023 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nuk rezultoi se subjekti të këtë ndjekur ndonjë çështje me palën shitëse shtetasin A. C., të pasurisë ***.

1.13 Analiza financiare e automjetit ***

Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit *** dt. 09.05.2013 - 300 euro

| Përshkrimi | Vlera |
|--|----------------|
| Të ardhura nga puna subjekti 01.01.13 - 09.05.13 | 352,580 |
| Të ardhura totale | 352,580 |
| Shpenzime jetese 01.01.13 - 09.05.13 | 101,067 |
| Shpenzime kontributi per prindërit 01.01.13 - 09.05.13 | 43,000 |
| Shpenzime udhëtimi 01.01.13 - 09.05.13 | 65,647 |
| Shpenzime totale | 209,714 |
| Blerje automjet *** dt.09.05.13 - 300€ | 42,063 |
| Ndryshimi i likuiditetit 31.12.12 - 09.05.13 | 52 |
| Mundësi financiare | 100,752 |

Nga analiza financiare, rezultoi se subjekti kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurisë automjet tip *** në vlerën 300 euro dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të periudhës.

1.14 Shpenzimet e zhdoganimit të deklaruara dhe të provuara për këtë automjet nga subjekti në përgjigje të pyetësorit 2, janë përfshirë në analizën financiare të vitit 2014. Kurse shpenzimet për impiantin e gazit në vlerën 450 euro nuk janë përfshirë pasi subjekti nuk i provoi me dokumentacion kryerjen e këtyre shpenzimeve.

b. Lidhur me të ardhurat nga kursimet ndër vite

1.15 Në fund të vitit 2015 (bazuar në deklaratat periodike vjetore) dukej se, subjekti kishte një gjendje progresive të kursimeve cash në shumën 1,060,000 lekë.

1.16 Kursimet ndër vite dhe ndryshimet e tyre (shtesa dhe pakësimet) të deklaruara nga subjekti si burim për blerjen e këtij automjeti, janë trajtuar në pikën 2 të këtij vendimi.

Analiza financiare e automjetit *.**

1.17 Komisioni përgatiti analizën financiare lidhur me mundësitë e subjektit dhe b/shortes për krijimin e pasurisë automjet tip *** me targa AA***, blerë me kontratën e datës 9.12.2016 në vlerën 4,500 euro.

1.18 Në këtë analizë financiare, të ardhurat nga shitja e automjetit *** në vitin 2016, janë llogaritur sa totali i shpenzimeve të provuara si të kryera nga subjekti për këtë automjet (çmimi i blerjes 300€ + zhdoganimi 12,638 lekë = **53,219 lekë**).

1.19 Çmimi i shitjes së automjetit tip *** në shumën 1,500 euro nuk është marrë si e ardhur e ligjshme në vlerën e saj të plotë sepse nuk u vërtetua pagesa e tatimit për diferencën e çmimit të shitjes me atë të blerjes (pra është marrë vlera prej 53,219 lekë).

1.20 Në këtë analizë financiare janë përfshirë të ardhurat nga puna e subjektit dhe bashkëshortes gjatë këtij viti deri në datën e blerjes së automjetit tip ***

Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit * dt. 09.12.2016**

| Përshkrimi | Vlera |
|---|------------------|
| Të ardhura nga puna subjekti 01.01.16 - 09.12.16 | 1,148,704 |
| Të ardhura nga puna b/shortja 01.01.16 - 09.12.16 | 574,104 |
| Të ardhura nga shitja e automjetit *** | 53,219 |
| Të ardhura totale | 1,776,027 |
| Shpenzime jetese 01.01.16 - 09.12.16 | 442,757 |
| Shpenzime kontributi per prinderit | 113,000 |
| Shpenzime udhetimi | 154,485 |
| Shpenzime totale | 710,241 |
| Blerje automjet *** dt. 09.12.16 - 4,500€ | 608,715 |
| Ndryshimi i likuiditetit 31.12.15 - 09.12.16 | -538,928 |
| Mundësi financiare | 995,999 |

1.21 Nga analiza financiare, rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurisë automjet tip *** në vlerën 4,500 euro dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të periudhës.

1.22 Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi problematika për këtë pasuri automjet të deklaruar nga subjekti në deklaratën vetting.

2. Deklarimi i gjendjes cash

2.1 Në deklaratën Vetting (plotësuar në datë 26.1.2017) subjekti ka deklaruar gjëndje Cash në shumën 400,000 lekë.

2.2 Subjekti ka deklaruar gjëndje Cash në banesë për herë të parë në deklaratën periodike vjetore për vitin 2013 në shumën prej 160,000 lekë.

2.3 Në deklaratën periodike për vitin 2014 subjekti ka deklaruar “Gjendje Cash, kursime nga paga si prokuror, 400,000 lekë”.

2.4 Në deklaratën periodike për vitin 2015, subjekti ka deklaruar “Kursime nga paga ime dhe b/shortes, ne gjendje Cash, 500,000 lekë”.

2.5 Nga analizimi i gjendjes progresive të kursimeve Cash të deklaruara gjatë viteve nga subjekti, duket se ai kishte kursime Cash gjendje në shumën 1,060,000 lekë në fillim të vitit 2016.

2.6 Në deklaratën periodike për vitin 2016, subjekti nuk ka deklaruar ndryshime të kursimeve Cash në rubrikën e pasurisë (zvogëlim të gjëndjes Cash) por deklaroi përdorimin e kursimeve të krijuara ndër vite të deklaruara në deklaratat e mëparshme vjetore, për blerje pasurie automjet.

2.7 Nga rezultati financiar pozitiv i viteve 2011 - 2016, rezultoi se, subjekti dhe b/shortja kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e gjendjes Cash në shumën 1,060,000 lekë deri në fund të vitit 2015.

2.8 Lidhur me mospërputhjen e DPV të vitit 2016 me deklaratën Vetting për gjëndjen e Cash dhe saktësimin e saj ndër vite është pyetur subjekti.

2.9 Në përgjigje të pyetësorit 3, subjekti deklaroi se, në vitin 2016 “kam pakësuar Cash pasi kam blerë mjetin tip *** me targa AA*** më datë 09.12.2016. Pakësimi nuk është deklaruar si rubrikë me vete në DPV-në e vitit 2016 por është shpjeguar pakësimi në rubrikën kur është deklaruar krijimi dhe burimi i pasurisë *** i blerë në vlerën 4.500 euro, duke shpjeguar se, kam përdorur për blerjen e këtij mjeti dhe kursimet ndër vite të deklaruara në deklaratat e mëparshme vjetore. Nga kursimet, në aq sa mbaj mend, kam përdorur afërsisht 550,000 lekë.

Gjithashtu, në Deklaratën Vetting kam saktësuar dhe gjëndjen Cash në banesë që ka qënë 400,000 lekë, dorëzuar në datë 26.01.2017, në ILDKPKI.

Si përfundim deklaroj deri në fund të vitit 2016 kam patur 400,000 lekë gjendje Cash në banesë si pasojë e kursimeve ndër vite”³

³ Shih përgjigjen e pyetësorit ***

2.10 Si referencë për llogaritjen e gjendjes Cash për subjektin u morën të dhënat dhe deklaratimet e DPV-ve të dorëzuara ndër vite nga subjekti pranë ILDKPKI-së. Lidhur me mundësitë financiare të subjektit për krijimin e gjendjes Cash ndër vite referohuni në tabelën e analizës financiare në pikën 10 të këtij vendimi.

2.11 Gjendja e kursimeve Cash në fund të vitit 2016 është vlerësuar nga Komisioni sa vlera e deklaruar në deklaratën Vetting (në shumën 400,000 lekë) për shkak të deklaratimit të përdorimit të kursimeve për blerjen e automjetit në DPV-në e vitit 2016 dhe për shkak të afërsisë në kohë nga deklarata Vetting me fundin e vitit 2016.

2.12 Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se, subjekti nuk ka deklaruar ndryshimin e gjendjes Cash (zvogëlimin e gjendjes Cash) në DPV-në e vitit 2016. Kjo pasaktësi ka sjellë mospërputhjen e DPV-së së vitit 2016 me deklaratën vetting përsa i përket gjendjes Cash.

2.13 Lidhur me këtë konstatim të gjendjes Cash, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime, i cili në përgjigje të rezultateve të hetimit ka shpjeguar se, *në vitin 2016 kam pakësuar gjendjen Cash pasi kam blerë mjetin tip *** me targa AA*** më datë 9.12.2016. Pakësimi nuk është deklaruar si rubrikë më vete në DPV-në e vitit 2016, por është shpjeguar pakësimi në rubrikën kur është deklaruar krijimi dhe burimi i pasurisë ***, i blerë në vlerën 4,500 euro, duke shpjeguar se kam përdorur për blerjen e këtij mjete dhe kursimet ndër vite të deklaruar në deklaratat e mëparshme vjetore. Nga kursimet kam përdorur afërsisht 550,000 lekë. Gjithashtu, në Deklaratën Vetting kam saktësuar dhe gjendjen Cash banesë që ka qënë 400,000 lekë, dorëzuar në datë 26.01.2017, në ILDKPKI. Kam menduar se përdorimi i kursimeve (gjendjes Cash në banesë) për blerjen e pasurisë automjet, do të sillte automatikisht edhe pakësimin e kursimeve, pa i specifikuar në rubrikën përkatëse. Deri në fund të vitit 2016 kam patur 400,000 lekë gjendje Cash në banesë si pasojë e kursimeve ndër vite.*

2.14 Pas përgjigjes së rezultateve të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se, pavarësisht detyrimit për deklarim të saktë të gjendjes cash (ndryshimeve progresive, duke nënkuptuar si shtesat edhe pakësimin e tij), në referim edhe të shpjegimeve përfundimtare të subjektit, nuk u konstatuan problematika që të mund të ndikonin në vlerësimin e kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

3. Lidhur me deklarimin e Kartës së kreditit.

3.1 Subjekti ka deklaruar kartë krediti visa në bankën “ Credins” në shumën 100.000 lekë. Kjo kartë duket se është marrë në vitin 2014, dhe me të nuk ishte kryer asnjë veprim, përveç mbajtjes së komisioneve mujore nga banka.

3.2 Credins Bank⁴, nuk konfirmon kartë krediti me gjendje debitore në emër të Xhelian Seferi e duke u nisur nga ky konfirmim i bankës nuk u konstatuan problematika nga Komisioni për këtë kartë krediti të subjektit.

⁴ Shiko përgjigjen e Credins bank në dosjen e ILDKPKI-së.

4. Lidhur me deklarinimin e subjektit për shtëpi banimi me qira.

4.1 Subjekti ka deklaruar se, nga muaji Janar 2017 ka marrë me qira një banesë 1+1, ndodhur në rr. “****”, Pallati “****”, kati ***, ap.***, Tiranë, në shumën 15,000 lekë në muaj.

Hetimi i kryer nga Komisioni

4.2 Me kontratë qeraje me nr. *** rep.e nr. *** kol., datë 24.1.2017, palë qiradhënëse D.M. i jep subjektit të rivlerësimit një ambient banimi me sipërfaqe 58.25 m2, ndodhur në rrugën “****”, kundrejt vlerës së qirasë 15,000 lekë/muaj për një afat 2 vjeçar, duke filluar nga data 1.1.2017. Sipas kontratës pala qiradhënëse merr përsipër të paguajë detyrimet sipas ligjit.

4.3 Bazuar në “Vërtetim nga dokumentet hipotekor”, (sipas regjistrit nr.*** datë 28.9.2015) kjo pasuri me sip. 58.28 m2, rezulton e regjistruar në pronësi të D.M. Kjo pasuri është marrë më qera nga subjekti në muajin Janar 2017, në periudhën e dorëzimit të deklaratës Vetting dhe shpenzimet e kryera nuk vlerësohen në analizën financiare për periudhën 2011-2016.

4.4 Bazuar ne shkresën e datës 17.3.2023 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe shkresës së datës 20.3.2023 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nuk rezultoi se subjekti të këtë ndjekur ndonjë çështje me palën qiradhënëse shtetasin D.M., duke arritur në përfundimin se, subjekti ka bërë deklarinim të saktë për këtë shtëpi banimi, të marrë me kontratë qiraje 2 vjeçare.

Deklarimi i bashkëshortes së subjektit znj. I. B.

5. Automjet ***

5.1 Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar automjet tip *** me targa AA****. Vlera 3,000 euro. Pjesa takuese 100%. Burim i krijimit: Blerë nga shitja e automjetit të mëparshëm si dhe paga e saj dhe e subjektit.

Hetimi i kryer nga komisioni

5.2 Rezultoi se, kjo pasuri automjet është blerë nga b/shortja e subjektit me kontratën nr. *** rep., nr.*** kol., dt.18.9.2014, në vlerën 3,000 euro. Palë shitëse e kësaj pasurie është shtetasi A.C. dhe palë blerëse I. B. Automjeti është vit prodhimi 2003, dhe vlera prej 3,000 euro është likuiduar plotësisht nga blerësi, jashtë zyrës noteriale. Për këtë pasuri është lëshuar dhe “Çertifikata e pronësisë së mjetit rrugor tip ***, targë AA****”, në pronësi të I.B.

5.3 DPSHTRR, ka konfirmuar se shtetasja I.B ka patur në pronësi automjetin me targë AA****. Kjo pasuri është shitur më datë 14.2.2017 me kontratën e shitblerjes nr.*** Rep., nr. *** Kol., me palë shitëse I.B dhe palë blerëse K.P., kundrejt vlerës 3,000 euro, vlerë e cila është likuiduar plotësisht nga blerësi, jashtë zyrës noteriale.

5.4 Bazuar ne shkresën e datës 17.3.2023 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe shkresës së datës 20.3.2023 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë nuk rezultoi se subjekti të këtë ndjekur ndonjë çështje me palën shitëse të pasurisë ***, z.A.C.

5.5 Analiza financiare për blerjen e kësaj pasurie është bazuar në dy burimet e deklaruara nga bashkëshortja e subjektit që janë: *“shitja e automjetit të mëparshëm si dhe paga e saj dhe e subjektit”*.

5.6 Rezultoi se, në vitin 2014 është shitur automjeti tip *** me targë AA*** në vlerën 2,200 euro. Ky automjet është blerë me kontratën nr.*** rep.,e nr.*** kol., datë 26.11.2013, në vlerën 2,200 euro dhe deklaruar në DPV-në e vitit 2013.

5.7 I pyetur për burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar në përgjigje të pyetësorit 2 se: *“Mjeti *** është blerë me të ardhurat e siguruara nga shitja e mjetit tip *** në vlerën 2,000 euro në datën 23.11.13. Ndërsa pjesa tjetër prej 200 euro është me të ardhurat e siguruara nga puna”*.

5.8 Sipas informacionit nga DPSHTRr-ja, automjeti tip *** në pronësi të shtetasës I.B është shitur në datën 23.11.2013, në vlerën 2,000 euro tek blerësi E.H. (pasuri e blerë në emër të b/shortes së subjektit para martesë).

5.9 Vlera prej 2,000 euro është përfshirë si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të mundësisë së blerjes së automjetit tip *** nga b/shortja e subjektit në datën 26.11.13.

5.10 Në analizën financiare të mundësisë së blerjes së automjetit tip *** në datën 26.11.2013 në vlerën 2,200 euro, përfshihet edhe teprica pozitive e periudhës 01.01.13-09.05.2013, në vlerën 100,752 lekë⁵.

5.11 Të ardhurat nga puna e b/shortes janë përfshirë në këtë analizë financiare, për periudhën 01.01.2013-26.11.2013. Në analizën financiare për periudhën 01.01.2001- 09.05.2013 nuk janë përfshirë të ardhurat e bashkëshortes për blerjen e automjetit ***, pasi subjekti ka deklaruar vetëm të ardhurat nga puna e tij për blerjen e këtij automjeti.

5.12 Nga analiza financiare, rezultoi se subjekti dhe b/shortja kishin pamjaftueshmëri financiare për krijimin e pasurisë automjet tip *** në vlerën 2,200 euro, shtimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të periudhës në shumën prej -336,933 lekë. Prandaj këto të ardhura, nuk u përfshinë nga Komisioni si të ardhura të ligjshme në analizën e mundësisë së subjektit dhe b/shortes së tij për blerjen e automjetit tip ***në datën 18.09.2014 në vlerën 3,000 euro.

⁵ Shih analizën financiare të mundësisë së blerjes së automjetit tip *** në pikën 1 të këtij vendimi.

5.13 Nga analiza financiare, rezultoi se subjekti dhe b/shortja kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurisë automjet tip *** në vlerën 3,000 euro, dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera të periudhës.

5.14 Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkuzionin se, subjekti nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e pasurisë automjet tip *** në vitin 2013.

5.15 Për sa më sipër subjektit të rivlerësimit iu la barrë prove për të dhënë argumentat dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016.

5.16 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar se, *mjeti *** është blerë në datë 26.11.2013, në vlerën 2,200 euro, me të ardhurat e siguruara nga shitja⁶ e mjetit tip *** në vlerën 2,000 euro në datë 23.11.2013. Ndërsa pjesa tjetër prej 200 euro është me të ardhurat e siguruara nga puna. Makina është blerë në emër të bashkëshortes, me të ardhurat tona familjare nga puna. Pra, burimi kryesor i blerjes së pasurisë automjet tip *** në datë 26.11.2013 është shitja më datë 23.11.2013 e mjetit tip *** në emër të bashkëshortes. Ndërsa pjesa tjetër prej 200 euro është me të ardhurat e siguruara nga puna.*”.

5.17 Pas përgjigjeve të subjektit ndaj rezultateve të hetimit, Komisioni hartoi dhe një herë analizat financiare të mundësisë së subjektit dhe b/shortes për krijimin e pasurive automjet tip *** në datën 26.11.2013 dhe automjet tip *** në datën 18.9.2014 si më poshtë. Në këto analiza financiare, është marrë në konsideratë në ndryshimin e likuiditeteve edhe llogaria bashkëmërore e b/shortes së subjektit dhe nënës së saj në pjesën takuese prej 50%.

Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit * dt. 26.11.2013**

| Përshkrimi | Vlera |
|--|----------------|
| Të ardhura nga puna subjekti 09.05.13 - 26.11.13 | 424,698 |
| Të ardhura nga puna b/shortja 01.01.13 - 26.11.13 | 46,800 |
| Të ardhura nga shitja e automjetit *** - 2,000€ | 280,420 |
| Teprica pozitive nga periudha 01.01.13 - 09.05.13 | 100,752 |
| Të ardhura totale | 852,670 |
| Shpenzime jetese 09.05.13 - 26.11.13 | 164,528 |
| Shpenzime kontributi për prindërit 09.05.13 - 26.11.13 | 70,000 |
| Shpenzime udhëtimi 09.05.13 - 26.11.13 | 150,025 |

⁶ Shih bashkëlidhur kontratë shitje me nr.*** rep. e nr. *** kol., dt.23.11.2013.

| | |
|--|----------------|
| Shpenzime totale | 384,553 |
| Blerje automjet *** dt.26.11.13 - 2,200€ | 308,462 |
| Ndryshimi i likuiditetit 09.05.13 - 26.11.13 | 246,588 |
| Pamundësi financiare | -86,933 |

5.18 Nga analiza financiare, rezultoi se subjekti dhe b/shortja kishin pamjaftueshmëri financiare për krijimin e pasurisë automjet tip *** në vlerën 2,200 euro, shtimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të periudhës në shumën prej 86,933 lekë. Prandaj këto të ardhura, nuk u përfshinë nga Komisioni si të ardhura të ligjshme në analizën e mundësisë së subjektit dhe b/shortes së tij për blerjen e automjetit tip *** në datën 18.09.2014 në vlerën 3,000 euro.

5.19 Analiza financiare e mundësisë së blerjes së automjetit tip ***

Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit * dt. 18.09.2014**

| Përshkrimi | Vlera |
|--|------------------|
| Të ardhura nga puna subjekti 01.01.14 - 18.09.14 | 801,491 |
| Të ardhura nga puna b/shortja 01.01.14 - 18.09.14 | 394,607 |
| Të ardhura nga shitja e automjetit *** 2014 | 0 |
| Të ardhura totale | 1,196,098 |
| Shpenzime jetese 01.01.2014 - 18.09.2014 | 95,332 |
| Shpenzime kontributi per prinderit 01.01.14 - 18.09.14 | 90,000 |
| Shpenzime udhetimi 01.01.14 - 18.09.14 | 163,511 |
| Shpenzime totale | 348,843 |
| Blerje automjet *** dt.18.09.14 - 3,000€ | 420,330 |
| Ndryshimi i likuiditetit 31.12.13 - 18.09.14 | -454,499 |
| Mundësi financiare | 881,424 |

5.20 Nga analiza financiare, rezultoi se subjekti dhe b/shortja kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurisë automjet tip *** në vlerën 3,000 euro, dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera të periudhës.

Vlerësimi i Komisionit:

5.21 Pas përgjigjeve të subjektit ndaj rezultateve të hetimit, rezultoi pamjaftueshmëri financiare e subjektit dhe b/shortes së tij për blerjen e automjetit tip ***, në vitin 2013, në shumën -86,933 lekë, vlerë e cila nuk mund të ndikojë në vlerësimin përfundimtar të kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

6. Overdraft

6.1 Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar marrjen e një overdrafti në shumën 138,906 lekë në bankën “ Raiffeisen Bank”. Detyrimi financiar 138.906 lekë. Për këtë subjekti ka paraqitur një vërtetim të datës 19.1.2017, mbi produktet bankare të klientit I.B në Raiffeisen Bank, ku evidentohet balanca e llogarisë në datë 31.12.2016, në shumën 138.906 lekë.

6.2 Raiffeisen Bank, ka konfirmuar llogari page në emër të I. B, me gjendje në datë 26.1.2017, në vlerën -94.192,67 lekë. Llogaria është e lidhur me overdraft me limit 140,000 lekë.

6.3 Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe konkretisht, deklarimi i përket datës 31.12.2016, ndërsa kërkesa dhe konfirmimi i bankës i përket datës 26.1.2019.

6.4 Sa më sipër, në përfundim të hetimit nuk janë konstatuar problematika për këtë overdraft.

7. Adresat e banimit

7.1 Subjekti ka deklaruar në deklaratën Vetting këto adresa:

- Njësia administrative nr.***, Rruga “****”, Pll. ***, Shk.*** Ap. *** Tiranë.
- Rr. ****, P****. “****”, kati ***, ap.***, Tiranë.

Hetimi i kryer nga Komisioni

7.2 Adresa Rr. “****” Pall. “****”, është pasuria apartament banimi ku subjekti ka lidhur kontratë qiraje. Kjo pasuri dhe marrëdhëniet e qirasë janë trajtuar më sipër në pikën 4 të këtij vendimi.

7.3 Adresa tjetër Rr. “****” Pall.*** Ap.*** Tiranë është adresa ku subjekti duket se ka jetuar dhe është rregjistruar në gjëndjen civile.

7.4 Në përgjigje të pyetsorit standard subjekti ka deklaruar se “Nga fillimi i detyrës dt.16.11.2011 kam jetuar në banesën e prindërve, ndodhur në Rr. “****”, Pall.***, Ap.***, Tiranë. Banesa është në pronësi të gjyshes shtetases Xh.S, e paregjistruar”.

7.5 Kjo pasuri apartament në rrugën “***” është përfitur nga gjyshja e subjektit Xh.S me anë të kontratës për privatizim banese më datë 19.8.1993, bazuar në ligjin nr.7652 datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesa shtetërore”.

7.6 Midis gjyshes së subjektit Xh.S (si qiramarrëse) dhe NK Banesave sipas formularit nr.*** “Kontratë për privatizimin Banesës” është lidhur kontrata e privatizimit të banesës Nr.***, Rr.***, Pall. ***.

7.7 Pra duket se kjo pasuri apartament në rrugën “***” është fituar nga gjyshja e subjektit në vitin 1993 me anë të privatizim, shumë vite para se subjekti të fillonte detyrën e magjistratit.

7.8 Sa më sipër, nuk u konstatuan problematika lidhur me këto 2 adresa dhe pasuri të deklaruar nga subjekti.

ÇËSHTJE TË TJERA

8. Llogari bashkëmërore e b/shortes së subjektit dhe nënës së saj tek BKT.

8.1 Nga të dhënat e dërguara nga BKT rezultoi se bashkëshortja e subjektit I. B ka hapur një llogari bashkëmërore me nënën e saj A.B në vitin 2012.

8.2 Sipas statement të llogarisë nr.*** tek BKT⁷ me emërtim A ose I.B, llogaria hapet me datë 26.11.2012.

8.3 Në datën 27.11.2012, A. B derdh në depozitë vlerën 500,000 lekë, vlerë kjo që kalon në depozitë. Kjo depozitë maturohet me datën 24.06.2013 në vlerën 508,961 lekë.

8.4 Në datën 24.06.2013 A.B derdh në llogari vlerën 491,038.9 lekë dhe vlera totale në llogari prej 1,000,000 lekë kalon në depozitë. Kjo depozitë maturohet në datën 03.04.2014 në vlerën 1,016,903.54 lekë dhe tërhiqet në të njëjtën datë nga A.B.

8.5 Këtë depozitë bankare subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk e kishin deklaruar në DPV dhe as në deklaratën Vetting.

8.6 Për këtë u pyet subjekti⁸ i cili ktheu përgjigje duke deklaruar se, *dua t’ju sqaroj se unë nuk kam qënë në dijeni të kësaj llogarie bashkëmërore të bashkëshortes time dhe nënës së saj në bankën BKT. Një fakt i tillë nuk më është vënë në dijeni as nga ILDKPKI-ja gjatë procesit të pyetjes prej tyre në dy periudha kur jam pyetur. Pas komunikimit me bashkëshorten dhe nënën e saj, për faktin se përse nuk më ka vënë në dijeni, me qëllim sigurisht deklaramin e kësaj llogarie nga ana ime në Deklaratën Vjetore përkatëse por edhe në Deklaratën Vetting, ka qënë për dy arsye:*

⁷ Shih përgjigje BKT me nr. *** prot., datë 08.10.2021, te dosja e Komisionit.

⁸ Shiko pyetsorin nr.*** dërguar subjektit.

Së pari, shuma e depozituar në këtë llogari nuk është e bashkëshortes sime dhe as e imja. Në këtë llogari nuk kemi kontribuar as unë dhe as bashkëshortja ime, si dhe nga kjo llogari nuk kemi përfituar asnjë të ardhur apo pasuri. Ka qënë nëna e bashkëshortes shtetasja A. B ajo që ka bërë veprime (derdhje/tërheqje) në këtë depozitë, pavarësisht se në llogari rezulton dhe emri i bashkëshortes time.

Së dyti, për shkak se nëna e bashkëshortes nuk ka patur informacion/dijeni mbi procedurën e hapjes së llogarisë bankare, atë e ka shoqëruar bashkëshortja ime në bankë, dhe si person që mund të bënte tërheqje është vendosur dhe bashkëshortja ime. Emri është vendosur për shkak se nëna e bashkëshortes ka vuajtur nga sëmundje të ndryshme, dhe në çdo rast nevojë dhe pamundësie fizike të saj, të tërhiqte shumën bashkëshortja. Deklaroj se bashkëshortja ime nuk ka bërë asnjë veprim me këtë llogari.

- *Tërheqja e shumës është bërë nga vetë nëna e bashkëshortes, dhe destinacionin e shumës unë nuk e di, pasi siç deklarova më lart nuk kam qënë në dijeni të kësaj llogarie.*

- *Vjerri dhe vjerra ime kanë një banesë private dy kateshe në lagjen nr.***, Durrës, të cilën në sezon veror e kanë dhënë me qera pushuesve që vijnë. Nuk kam si ta provoj burimin e kësaj llogarie bankare, por kjo shumë duhet të jetë kursime të tyre ndër vite si pasojë e kësaj veprimtarie.*

8.7 Për këtë subjekti në përgjigje të pyetsorit ka paraqitur dhe një deklaratë noteriale⁹ të datës 9.3.2023, të deklaruës A.B (nëna e b/shortes së subjektit) ku referohen të njëjtat deklaratime që ka bërë dhe subjekti në përgjigje të pyetsorit nr.***.

8.8 Komisioni konstatoi, që subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë depozituar vlera financiare në këtë llogari bankare dhe që këto shuma të depozituara në llogari nuk janë përdorur si burim nga ata.

8.9 Gjithsesi rezultoi se kjo depozitë bankare bashkëemërore është krijuar nga bashkëshortja e subjektit gjatë martesës dhe nuk është deklaruar asnjëherë në deklaratat e pasurisë. Për këtë depozitë subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me të ardhurat e pretenduara që kanë shërbyer për krijimin e saj.

8.10 Komisioni ripyeti subjektin e rivlerësimit lidhur me burimin e krijimit të kësaj depozite si dhe të sqaronte se kush është znj.A.B, e cila ka depozituar shumën financiare në depozitën bashkëemërore të bashkëshortes së tij.

8.11 Në përgjigje të pyetsorit nr.*** subjekti deklaroi se, *nuk kam dokumentacion provues për të ardhurat e vjehrrës time dhe familjes së saj për krijimin e llogarisë bankare në vitin 2012. Burim janë të ardhurat nga dhënia me qira e banesës për pushuesit dhe për këtë aktivitet nuk lidhen kontrata qeraje pasi është aktivitet i parregulluar me ligj. Shuma e depozituar në këtë llogari nuk është as e imja as e bashkëshortes dhe as nuk kemi kontribuar apo përfituar të ardhura. Vjehrra ime nuk është as person i lidhur dhe as person tjetër i lidhur dhe kjo llogari*

⁹ Shiko deklaratën noteriale nr.*** rep., nr.*** kol., datë 9.3.2023, paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetsorit në dosjen e Komisionit.

nuk ka shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie nga unë apo bashkëshortja. Ndërsa, në lidhje me depozitimin e shumës nga shtetësja A. B, deklaroj në përgjegjësi të plotë se ky është një gabim material/lapsus i kryer nga punonjësja e bankës në momentin kur vjehrra A.B ka bërë depozitimin e shumës më datë 24.6.2013. Bashkëshortja dhe vjehrra nuk njohin ndonjë shtetase me emrin A.B..

8.12 Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se, subjekti nuk ka deklaruar në DPV-të përkatëse dhe në deklaratën Vetting llogarinë 2-emërore të bashkëshortes dhe nënës së saj. Subjekti nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj depozite.

Në analizën financiare për vitet 2012 - 2013 të hartuar për subjektin e rivlerësimit është përfshirë dhe depozita bankare bashkëmërore e bashkëshortes së subjektit dhe nënës së saj.

8.13 Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu la barrë prove për të dhënë argumentat dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit:

8.14 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti mbajti të njëjtin qëndrim në lidhje me këtë llogari bashkëmërore të bashkëshortes së tij dhe nënës së bashkëshortes A.B. Ai pohon se është i saktë konstatimi i Komisionit në lidhje me faktin se kjo llogari duhej të ishte deklaruar në DPV-në e vitit 2012 në rubrikën përkatëse të personit të lidhur (bashkëshortes time) por kjo ka ndodhur sepse nuk është treguar një fakt i tillë. Kjo shumë e depozituar nuk është e bashkëshortes së tij dhe as e tij për shkak se siç pohon ai, ata nuk kanë kontribuar për krijimin e saj si dhe nuk kanë përfituar të ardhura apo pasuri prej saj. Sipas vërtetimit nr.*** prot., datë 7.3.2023 të BKT dhe statement bashkëlidhur, të dorëzuar si provë në përgjigje të pyetsorit nr. ***, ka qënë nëna e bashkëshortes shtetësja A.B. ajo që ka bërë veprime (derdhje/tërheqje) në këtë depozitë, pavarësisht se në llogari rezulton dhe emri i bashkëshortes I.B.

8.15 Gjithashtu subjekti sqaron se, për shkak se nëna e bashkëshortes nuk ka patur informacion/dijeni mbi procedurën e hapjes së llogarisë bankare, atë e ka shoqëruar bashkëshortja e tij në bankë. Sipas tij, ajo është vendosur si person që mund të bënte tërheqje, duke qënë se nëna e bashkëshortes ka vuajtur nga sëmundje të ndryshme, dhe në çdo rast nevojë dhe pamundësie fizike të saj, të kryente veprimet e bija. Subjekti deklaroi se bashkëshortja e tij nuk ka bërë asnjë veprim me këtë llogari. Tërheqja e shumës është bërë nga vetë nëna e bashkëshortes dhe destinacionin e shumës së tërhequr nuk e di.

Në përfundim subjekti sqaron edhe njëherë se, për shkak se vjehrra e tij nuk është person i lidhur dhe as person tjetër i lidhur dhe se kjo llogari nuk ka shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie nga ai dhe/ose bashkëshortja e tij, nuk duhej ti ishte kaluar barrë prove/ kërkesë për shpjegime për këtë llogari bankare.

Vlerësimi i Komisionit:

8.16 Pas propozimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me llogarinë bashkëemërore të bashkëshortes së subjektit dhe nënës së saj tek BKT, Komisioni konsideroi faktin se subjekti nuk ka patur dijeni për ekzistencën e kësaj llogarie, nuk ka kontribuar as ai dhe as b/shortja në krijimin e saj si dhe nuk i kanë përdorur këto likuiditete për krijim pasurie.

8.17 Megjithatë, Komisioni vlerësoi se, subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij duhet ti lihet në ngarkim vetëm pjesa takuese e b/shortes (50% e vlerës) duke qënë se është llogari bashkëemërore.

8.18 Mbetet i pavërtetuar burimi i ligjshëm i krijimit të kësaj pasurie likuiditet bankar në bashkëpronësi të b/shortes së subjektit dhe nënës së saj në vitet 2012 – 2013.

9. Lidhur me pasuritë dhe likuiditetet e prindërve të subjektit dhe bashkëshortes së tij.

9.1 Nga Komisioni është hetuar lidhur me pasuritë e prindërve të subjektit lidhur me krijimin e ndonjë pasurie të mundshme të prindërve të subjektit gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës si magjistrat dhe për këtë është pyetur subjekti dhe në përgjigje të pyetsorit nr.***, më datë 3.7.2023 subjekti ka deklaruar se:

- *Deklaroj me përgjegjësi të plotë se babai V. S nga viti 2011 deri më datë 2.8.2015 (datë në të cilën ka ndërruar jetë) nuk ka blerë pasuri të paluajtshme. Për këtë nuk kam dokumentacion apo vërtetim pasi nuk kam si të aplikoj në ASHK në emër të babait.*
- *Deklaroj më përgjegjësi të plotë se, mamaja S.S nga vitit 2011 deri më sot nuk ka blerë pasuri të paluajtshme. Për këtë kam aplikuar pranë ASHK dhe në momentin që do pajisem me vërtetim përkatës do jua vë në dispozicion.*

9.2 Komisioni hetoi lidhur me gjëndjet e likuiditeteve bankare të prindërve të subjektit dhe prindërve të bashkëshortes së tij dhe ndryshimet e tyre ndër vite.

9.3 Për këtë iu drejtua me shkresë të gjitha bankave të nivelit të dytë dhe institucioneve të ndryshme financiare.

9.4 Nga përgjigjet e dërguara nga këto institucione bankare dhe financiare, rezultojnë kryesisht llogari pagash të prindërve të subjektit dhe bashkëshortes.

9.5 Në lidhje me këtë hetim, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me likuiditetet e personave të sipërpërmendur.

9.6 Gjithashtu, është administruar dokumentacioni shkresor bazuar në korrespondencën e mbajtur me institucionet shtetërore dhe private dhe me subjektin e rivlerësimit. Është kontrolluar i gjithë dokumentacioni i paraqitur nga bankat, ASHK, DPSHTRR, DPPP, DPPSH, AMF, TIMS, FSHU etj, si dhe dosja e ILDKPKI-së dhe nuk janë konstatuar problematika lidhur me vlerësimin e pasurisë për subjektin Xhelian Seferi.

9.7 Në përfundim Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë lidhur me deklarin e subjektit dhe nuk rezultoi ndonjë indicie për pasuri të paluajtshme të krijuar nga prindërit e subjektit gjatë periudhës që ai ka ushtruar detyrën e magjistratit.

10. Analiza financiare

10.1 Analiza financiare është bërë për periudhën 16.11.2011-31.12.2016 duke përfshirë periudhën e rivlerësimit të këtij subjekti nga data e emërimit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

10.2 Nga analiza financiare, rezultoi se subjekti dhe b/shortja e tij kishin pamjaftueshmëri totale financiare në vlerën **-567,426 lekë** për shtimin e pasurive dhe likuiditeteve si dhe për mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës 16.11.2011 - 31.12.2016.

10.3 Për sa më sipër subjektit të rivlerësimit iu la barrë prove për të dhënë argumentat dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit:

10.4 Në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare, subjekti ka shpjeguar se, Komisioni ka përfshirë edhe llogarinë bankare në emër të vjehrrës dhe bashkëshortes së tij duke shpjeguar edhe njëherë qëndrimin e tij në lidhje me këtë llogari bankare dhe duke sqaruar se, nëse në këtë analizë financiare nuk do të përfshihej kjo llogari bankare, rezultati do të ishte pozitiv. Gjithsesi edhe nëse përfshihet llogaria e mësipërme bankare, referuar praktikës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit në raste të ngjashme, bashkëshortes duhet t'i llogaritet gjysma e vlerës së kësaj llogarie duke rezultuar përsëri me mundësi financiare.

Pas përgjigjes së subjektit ndaj rezultateve të hetimit, Komisioni hartoi dhe një herë analizën financiare të periudhës 16.11.2011 – 31.12.2016 si më poshtë:

| SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: XHELIAN V. SEFERI - 16.11.11 - 31.12.16 | | | | | | | |
|--|---------------------|-----------|-----------|-------------------------------------|-----------|-----------|-----------------|
| PERSHKRIMI | 16.11.11 - 31.12.11 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | TOTAL |
| PASURI | -79 | 628,310 | 759,554 | 322,933 | 378,583 | -70,838 | 1,756,814 |
| Automjet **** - 2012 - 2,700 euro - 100% - b/shortja | | 377,244 | | | | | 377,244 |
| Automjet **** - 2013 - 300€ - 100% - subjekti | | | 42,063 | | | | 42,063 |
| Automjet **** - 2013 - 2,200€ - 100% - b/shortja | | | 308,462 | | | | 308,462 |
| Automjet **** - 2014 - 3,000€ - 100% - b/shortja | | | | 420,330 | | | 420,330 |
| Automjet **** - 2016 - 4,500€ - 100% - subjekti | | | | | | 608,715 | 608,715 |
| Ndryshim ne likuiditet | -79 | 251,066 | 409,029 | -97,397 | 378,583 | -679,553 | |
| DETYRIME | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | | | | 0 |
| PASURI NETO (PASURI - DETYRIME) | -79 | 628,310 | 759,554 | 322,933 | 378,583 | -70,838 | 1,756,814 |
| TE ARDHURA TE DOKUMENTUARA | 111,470 | 1,310,593 | 1,253,299 | 2,025,025 | 1,857,098 | 1,793,335 | 8,350,821 |
| Te ardhura nga puna subjekti | 111,470 | 883,007 | 849,707 | 1,139,624 | 1,201,709 | 1,166,012 | 5,351,529 |
| Te ardhura nga puna b/shortja e subjektit | 0 | 50,342 | 123,172 | 577,159 | 655,389 | 574,104 | 1,980,167 |
| Te ardhura nga shitja e automjetit **** - 2013 - 2,000€ | | | 280,420 | | | | 280,420 |
| Te ardhura nga shitja e automjetit **** - 2014 - 2,200€ | | | | 308,242 | | | 308,242 |
| Te ardhura nga shitja e automjetit **** - 2016 - 1,500€ | | | | | | 53,219 | 53,219 |
| Te ardhura nga pasuri paramartesore b/shortja - 2012 | | 377,244 | | | | | 377,244 |
| SHPENZIME | 32,078 | 624,334 | 619,121 | 767,244 | 841,489 | 744,669 | 3,628,936 |
| Shpenzime jetese | 17,078 | 197,693 | 282,048 | 439,996 | 448,552 | 470,184 | 1,855,551 |
| Shpenzim per kontribut tek familja prinderore | 15,000 | 120,000 | 120,000 | 120,000 | 120,000 | 120,000 | 615,000 |
| Shpenzime per automjetin Fiat - 2014 | | | | 12,638 | | | 12,638 |
| Shpenzim dhene familjes shperblimi pas vdekjes se babait - 2015 | | | | | 50,000 | | 50,000 |
| Shpenzime udhetimi | | 306,641 | 217,073 | 194,610 | 222,937 | 154,485 | 1,095,747 |
| Analiza dokumentuar | 79,472 | 57,950 | -125,376 | 934,847 | 637,025 | 1,119,505 | 2,703,423 |
| | | | | Pamundesia financiare totale | | | -125,376 |
| Gjendje CASH (deklarimet periodike) | | | 160,000 | 560,000 | 1,060,000 | 400,000 | |
| Likuiditete ne fund viti | 787 | 251,852 | 660,881 | 563,485 | 942,068 | 262,514 | |

10.5 Nga analiza financiare, rezultoi se subjekti dhe b/shortja e tij kishin pamjaftueshmëri totale financiare në vlerën **-125,376 lekë** për shtimin e pasurive dhe likuiditeteve si dhe për mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës 16.11.2011 - 31.12.2016.

11. Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe b/shortes, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga: Raiffeisen Bank, BKT, Credins Bank dhe gjendjet e kursimeve Cash të deklaruara nga subjekti.

Lidhur me llogarinë bashkëemërore në emër të bashkëshortes së subjektit dhe nënës së saj pranë BKT, në përfundim, Komisioni përfshiu në analizën financiare pjesën takuese (50%) të kësaj llogarie si pasuri e bashkëshortes në bashkëpronësi me nënën e saj.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

(i) Të ardhurat nga pagat e subjektit si prokuror tek: Prokuroria në Gjykatën e Shkallës së parë Tiranë (16.11.2011 - 2012), Prokuroria në Gjykatën e Shkallës së parë Elbasan (2012 – 2016)

(ii) Të ardhura të subjektit nga shpërblimi pas vdekjes së babait nga Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë(2015).

(iii) Të ardhurat e b/shortes së subjektit tek: Fondacioni S (Universiteti B) – (2012 – 2015), tek KLD (2014 – 2016), nga mësimdhënia tek Universiteti A. M në Durrës (2013)

(iv) Të ardhurat nga shitja e automjetit tip ***, sipas kontratës së shitjes (2013)

(v) Të ardhurat nga shitja e automjetit tip ***, sipas kontratës së shitjes (2014)

(vi) Të ardhurat nga shitja e automjetit tip *** sipas vlerës së deklaruar nga subjekti për blerjen e automjetit dhe zhdoganimit të tij (2016)

(vii) Të ardhurat nga pasuri paramartesore e b/shortes (2012)

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

(i) Shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes, (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT);

(ii) Shpenzime për kontributin e subjektit ndaj familjes prindërore, sipas deklarimit të subjektit në përgjigje të pyetësorit standart (2011 – 2016).

(iii) Shpenzim dhene familjes shpërblimi pas vdekjes së babait – 2015, sipas deklarimit të subjektit në përgjigje të pyetësorit.

(iv) Shpenzim për automjetin tip *** (2014) për zhdoganimin sipas deklarimit të subjektit në përgjigje pyetësori dhe provave të dokumentuara.

(v) Shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi TIMS. Për përlogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019 (J.R.) dt. 22/05/2019 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti ka deklaruar e dokumentuar udhëtime për qëllime pune dhe ato për të cilat janë dokumentuar qëndrim pranë njerëzve të afërm.

ç. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/shitblerjeve të këtyre pasurive¹⁰.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit:

Komisioni, në vlerësimin e çështjes në lidhje me kriterin e pasurisë, bazuar në provat që disponon, si dhe bindjen e brendshme, çmon se, se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të mjaftueshëm për pasuritë e krijuara, si dhe justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, duke zbritur dhe shpenzimet e jetesës, sipas përcaktimeve të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit Nr.8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Xhelian Seferi.

Ky institucion ka verifikuar deklaramet e subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë krimin e organizuar, sipas parimeve e kushteve të parashikuara në nenin “Dh”, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit 84/2016.

Pas kryerjes të të gjitha procedurave për kontrollin në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 4 dhe nenin 37 dhe 38 të ligjit 84/2016, ka paraqitur pranë KPK raportin përfundimtar mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. Xhelian Seferi, me nr.*** prot., datë 2.11.2017, ku ka konstatuar se:

- *Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin 84/2016.*
- *Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njejtat gjeneralitete si ato të deklaramuara në Deklaramtën për kontrollin e figurës.*
- *Për subjektin e rivlerësimit administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme dhe përfshirjen e tij në veprimtari të kundraligjshme.*
- *Konstatohet se subjekti i rivlerësimit Xhelian Seferi, është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës.*

Me shkresën nr. *** prot., datë 9.2.2023 iu kërkua DSIK-së, përditësimi dhe deklasifikimi i raportit të figurës për subjektin e rivlerësimit.

¹⁰ Shih kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme, në dosjen e ILDKPKI-së.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit 10/2023 datë 2.2.2023 “Për informacionin e klasifikuar”, më datë 9.3.2023, i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, i ndryshuar, bazuar në nenin 63 të këtij ligji emërtimi i DSIK ka ndryshuar në Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK).

Më datë 16.5.2023, me shkresën nr.*** prot., është paraqitur raporti i deklasifikuar pjesërisht i Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK)¹¹.

Në këtë raport nga grupi i punës së AKSIK konstatohet se, për subjektin e rivlerësimit Xhelian Seferi:

- Administrohen informacione kofidenciale apo informacione të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, ose persona të dyshuar të krimit të organizuar;

- Informacionet në ngarkim të tij për implikim në veprimtari korruptive në më shumë se një rast e bën subjektin e rivlerësimit në mbështetje të gërmave b dhe c të nenit 37 të ligjit 84/2016, person me tendencë për përfshirjen në veprimtari kriminale dhe një individ që mund të vihet lehtësisht nën presion nga strukturat kriminale;

- Informacionet që disponohen evidentojnë rrethanat e konstatimit të faktit se ekziston një kontakt i papërshtatshëm që sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 3 të ligjit 84/2016, në formën e një takimi të qëllimshëm në papajtueshmëri me ushtrimin e detyrës së subjektit;

- Gjithashtu sipas përcaktimit të pikës 8 të nenit 3 të ligjit 84/2016 që përfshin veprat penale sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, subjekti është përfshirë në veprimtari të kundraligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit pasiv të prokurorit;

- Për subjektin e rivlerësimit Xhelian Seferi konstatohet papërshtatshmëria për vazhdimin e detyrës.

Komisioni kreu një hetim administrativ për subjektin e rivlerësimit Xhelian Seferi me qëllim verifikimin e veprimtarisë dhe çështjeve të ndjekura nga ai, për të vërtetuar nëse subjekti gjendet në kushtet e papajtueshmërisë së ushtrimit të detyrës për shkak të kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe nëse ka kryer veprime të tjera të kundraligjshme.

Lidhur me këtë Komisioni kërkoi pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan¹² vënien në dispozicion të 5 çështjeve penale të ndjekura nga subjekti i rivlerësimit, e cila ka dërguar¹³ praktikën lidhur me këto 5 çështje penale, të trajtuara më poshtë në këtë vendim pas vlerësimit profesional për subjektin Xhelian Seferi.

¹¹ Ky raport i kontrollit të figurës është deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr.*** datë 10.5.2023 të AKSIK.

¹² Me shkresën me nr.*** prot., datë 29.5.2023.

¹³ Me shkresën me nr.*** datë 5.6.2023

Në përfundim të hetimit administrativ dhe në vlerësim të të dhënave që disponohen për subjektin e rivlerësimit, Komisioni konstatoi se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë kontakte të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- Subjektit i rivlerësimit e ka dorëzuar në kohë deklaratën e kontrollit të figurës sipas ligjit;
- Subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklaram të pasaktë dhe nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elementë që vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve e kushteve të parashikuara në nenin Dh, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit 84/2016, duke përfshirë edhe lëvizjet e subjektit për hyrje daljet jashtë vendit sipas informacionit nga sistemi TIMS.

Deklarimet e subjektit kanë rezultuar të sakta dhe të vërteta.

Komisioni vlerëson se, subjekti i rivlerësimit z. Xhelian Seferi ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të gërmës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE

Ky raport është përgatitur për vlerësimin profesional, të subjektit të rivlerësimit z. Xhelian Seferi. Për periudhën e rivlerësimit Xhelian Seferi ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) Aftësitë profesionale;
- b) Aftësitë organizative;
- c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) Formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) 5 dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) Të dhënat nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe KLP.

Subjekti Xhelian Seferi me Dekret të Presidentit të Republikës Nr.***, datë 16.11.2011 është caktuar si prokuror në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Me Dekretin Nr. ***, datë 12.10.2012 është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Me Urdhrat Nr. 187, datë 16.10.2012 dhe Nr. 60, datë 15.02.2013 të Prokurorit të Përgjithshëm është komanduar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Tre dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

1. **Dokumenti ligjor:** Vendim për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal Nr. ***, regjistruar në datën 02.03.2015.
2. **Dokumenti ligjor:** Vendim për pushimin e procedimit penal Nr. ***, regjistruar në datën 30.09.2016.
3. **Dokumenti ligjor:** Kërkesë për gjykimin e procedimit penal Nr. ***, të regjistruar në datën 04.12.2013 dhe konkluduar në datën 01.08.2014.

Përshkrimi i 5 dosjeve penale dhe dokumenteve ligjore të përzgjedhura me short.

Dosja 1. Kallëzimi penal Nr. ***, datë regjistrimi 13.09.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Dokumenti ligjor - *Vendim "Për mosfillimin e procedimit penal"*, datë 04.10.2016, përpiluar nga prokurori Xhelian Seferi, subjekt rivlerësimi.

Akti është i arsyetuar dhe mbështetet në rrethanat e dala gjatë hetimit. Baza ligjore e vendimit të mosfillimit të procedimit penal është identifikuar drejtë. Ka përputhje midis pjesës arsyetuese të vendimit, bazës ligjore të identifikuar dhe dispozitivit. Në vendim janë arsyetuar shkaqet ligjore të mosfillimit të procedimit penal. Teksti përmban referenca ligjore.

Vendimi i mosfillimit i procedimit penal është marrë brenda afatit 30 ditor, të parashikuar në Udhëzim Nr.3, datë 19.06.2012 "*Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin Nr.241, datë 21.11.2005 "Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale"* i ndryshuar" i Prokurorit të Përgjithshëm.

Referuar vërtetimit të lëshuar nga Nënkryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan nuk rezulton që shtetasja A.L. të ketë paraqitur ankim ndaj vendimit të mosfillimit.

Dosja 2. Procedimi penal Nr. ***, regjistruar në datën 04.11.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Elbasan. Dokumenti ligjor – *Vendim "Për pushimin e procedimit penal"*, datë 24.10.2015, përpiluar nga prokurori Xhelian Seferi, subjekt rivlerësimi.

Akti është i arsyetuar dhe mbështetet në rrethanat e dala gjatë hetimit. Baza ligjore e vendimit të pushimit të procedimit penal është identifikuar drejtë, duke përdorur edhe referenca të tjera ligjore. Ka përputhje midis pjesës arsyetuese të vendimit, bazës ligjore të identifikuar dhe dispozitivit. Në vendim janë arsyetuar shkaqet ligjore të pushimit të procedimit penal. Teksti përmban referenca ligjore.

Në vendim Prokurori ka disponuar edhe për detyrimin e njohjes së personit nën hetim, me qëllim që të ushtrohet e drejta e ankimit në Gjykatë. Vendimi mban nënshkrimin e subjektit të rivlerësimit Xhelian Seferi, në cilësinë e prokurorit të çështjes. Me shkresën Nr. ***.Prot, datë 10.11.2015, vendimi i është dërguar për njoftim shtetasit nën hetim P.A.

Referuar vërtetimit të lëshuar nga Nënkryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan nuk rezulton që shtetasi P.A. të ketë paraqitur ankim ndaj vendimit të pushimit.

Dosja 3. Procedimi penal Nr. ***, regjistruar në datën 06.01.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Dokumenti ligjor – *Vendim "Për pushimin e procedimit penal"* datë 03.02.2014, hartuar nga Prokurori Xhelian Seferi, subjekt rivlerësimi.

Akti është i arsyetuar dhe mbështetet në rrethanat e dala gjatë hetimit. Baza ligjore e vendimit të pushimit të procedimit penal është identifikuar drejtë, duke përdorur edhe referenca të tjera ligjore. Ka përputhje midis pjesës arsyetuese të vendimit, bazës ligjore të identifikuar dhe

dispozitivit. Në vendim janë arsyetuar shkaqet ligjore të pushimit të procedimit penal. Teksti përmban referenca ligjore.

Në vendim Prokurori ka disponuar edhe për detyrimin e njohjes së viktimës dhe subjektit referues, me qëllim që të ushtrohet e drejta e ankimit në Gjykatë. Vendimi mban nënshkrimin e subjektit të rivlerësimit Xhelian Seferi, në cilësinë e prokurorit të çështjes. Me shkresat Nr. ***.Prot, datë 18.02.2014 dhe Nr. ***.Prot, datë 18.10.2014, vendimi i është dërguar për njoftim shtetasit Y. Ç. dhe Komisarariatit të Policisë Librazhd.

Referuar vërtetimit të lëshuar nga Nënkyetari i Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan nuk rezulton që shtetasi Y. Ç. të ketë paraqitur ankim ndaj vendimit të pushimit.

Dosja 4. Procedimi penal Nr. ***, regjistruar në datën 09.09.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Objekti i shortit: Dokumenti ligjor – Kërkesë “Për gjykimin e procedimit penal” datë 10.09.2014, hartuar nga Prokurori Xhelian Seferi, subjekt rivlerësimi.

Kërkesa mbështetet në nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale dhe përmban strukturën dhe elementët e përcaktuar e të kërkuar nga kjo dispozitë procedurale.

Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt, paragrafët janë të ndarë nga njëri tjetri, teksti paraqitet i kuptueshëm. Nga përmbajtja e dokumentit rezulton se, përmenden në arsyetim normat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Akti është i arsyetuar. Kërkesa për gjykim përmban nënshkrimin e prokurorit Xhelian Seferi dhe është hartuar konform parashikimit të nenit 331/3 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan me Vendimin Nr. ***, datë 19.09.2014 ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit dhe dënimin përfundimtar me 20 ditë burgim. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 29.09.2014 pasi nuk është ankimuar.

Dosja 5. Procedimi penal Nr. ***, regjistruar në datën 12.03.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. kti i shortit: Dokumenti ligjor – Kërkesë “Për gjykimin e procedimit penal”, datë 09.04.2015, përpiluar nga Prokurori Xhelian Seferi, subjekt rivlerësimi.

Kërkesa mbështetet në nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale dhe përmban strukturën dhe elementët e përcaktuar e të kërkuar nga kjo dispozitë procedurale.

Nga përmbajtja e dokumentit rezulton se, përmenden në arsyetim normat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Akti është i arsyetuar. Kërkesa për gjykim përmban nënshkrimin e prokurorit Xhelian Seferi dhe është hartuar konform parashikimit të nenit 331/3 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan me Vendimin Nr. ***, datë 05.05.2015 ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit dhe dënimin e tij përfundimtar me 1 vit burgim. Ky vendim ka marrë formë të prerë me Vendimin Nr. ***, datë 02.02.2016 të Gjykatës së Apelit Durrës që ka lënë në fuqi vendimin.

Të dhëna nga burime arkivore

Nga të dhënat pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit nuk është marrë ndonjë masë disiplinore.

Për subjektin e rivlerësimit Xhelian Seferi janë administruar informacionet si më poshtë.

- Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë (Ish Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë) me shkresën nr. ***.Prot, datë 29.09.2020 ka konfirmuar se është regjistruar procedimi penal Nr. ***, i vitit 2015 ku subjekti i rivlerësimit Xhelian Seferi është kallëzuar nga shtetasi H. D për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i K. Penal, por pas hetimeve të kryera ky procedim penal është pushuar në datën 28.01.2016.
- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë me shkresën Nr. ***.Prot, datë 27.08.2020 ka dërguar informacion se ndaj subjektit të rivlerësimit Xhelian Seferi është paraqitur kallëzimi penal Nr. ***, i vitit 2019 nga shtetasi E. K i cili rezulton subjekt nen hetim për veprën penale të parashikuar nga neni 76-22 i K. Penal. Për këtë kallëzim është vendosur mosfillimi i procedimit penal me vendimin e datës 12.04.2019.
- Sektori Protokoll – Arkiv në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën Nr. *** Prot, datë 28.09.2020, ka dërguar informacion se për subjektin e rivlerësimit Xhelian Seferi përgjatë periudhës 2006 – 2020 është regjistruar 1 ankes dhe konkretisht ankesa Nr. ***, e vitit 2020 e shtetasis A.K i cili rezulton i përfshirë në hetim si pjesë e stafit mjekësor që kuronte një grua që ka gjetur vdekjen gjatë lindjes në ambientet e Spitalit Rajonal Elbasan, kërkesë që i është dërguar për kompetencë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.

ANALIZA E GJETJEVE

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: - formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; - pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe - të dhënat nga burimet arkivore në Drejtorisë Ekonomike dhe të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Në funksion të qartësisë së analizës së gjetjeve, tre aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimi referohen sipas radhës së paraqitur në Pjesën I të këtij raporti, me termat “*dokumenti 1, dokumenti 2, dokumenti 3*”. Ndërsa 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, referohen sipas radhës së paraqitur në Pjesën II të këtij raporti, me termat “*dosja 1, dosja 2, dosja 3, dosja 4 dhe dosja 5*”.

Subjekti i rivlerësimit Xhelian Seferi ka ushtruar kompetencat që ligji i njuh prokurorit, në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale, kontrollit dhe mbikëqyrjes të policisë gjyqësore. Prokurori ka kryer detyrat e tij në pajtim me pikat 2 dhe 2. 1 të Urdhrit Nr.147, datë 09.05.2008 të Prokurorit të Përgjithshëm “*Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në Prokuroritë e shkallës së parë*” që përcakton se, vendimi i mosfillimit të procedimit, vendimi i pushimit të çështjes, kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal, vendimi i zgjatjes së afatit të hetimeve, kërkesa për gjykimin e çështjes, konkluzionet përfundimtare dhe urdhrat në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale formulohen, arsyetohen dhe nënshkruhen nga prokurori i çështjes dhe detyrimin e prokurorit të çështjes për të diskutuar paraprakisht me Drejtuesin e Prokurorisë.

Niveli i arsytimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal dhe Kushtetutës, të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, Prokurori subjekt rivlerësimi, ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit prokurori Xhelian Seferi, është efikas dhe efektiv.

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Xhelian Seferi, merr pjesë në gjykim si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve, është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Xhelian Seferi dhe nga pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Nga tre dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar.

Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cënuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

D. DENONCIME

Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur 11 denoncime. Disa nga denoncimet janë të përsëritura dhe gjithsej rezultojnë **7 denoncime** për subjektin Xhelian Seferi.

1. Denoncim i përsëritur i shtetasve K. H dhe D.D me nr. *, datë 22.4.2022; nr. *** prot., datë 4.5.2022 dhe nr. *** prot., datë 5.5.2022.**

Këta shtetas ankohen ndaj prokurorit Xh. Seferi për çështjen penale kundër të pandehurve K.M., Q. B., D. D dhe K. H. Sipas denoncieve prokurori Seferi në diskutimin e tij përfundimtar “Për procedimin penal nr. ***/2014”, në seancën e datës 3.3.2022 është shprehur se, *gjatë gjykimit janë shqyrtuar të gjitha provat në proces*, por në fakt gjatë gjithë zhvillimit të procesit nuk është njohur me kërkesat e të paditurve dhe i ka quajtur të pavlefshme provat e reja që kanë dalë gjatë procesit civil të vitit 2019 po në gjykatën e Elbasanit, si dhe nuk është shprehur për pozicionin e të pandehurve.

Për këtë çështje, Komisioni ju drejtua Prokurorisë së rrethit gjyqësor Elbasan me kërkesën¹⁴ për vënie në dispozicion të kopjes së praktikës së procedimit penal nr. ***/2014 si dhe informacion në lidhje me ecurinë e kësaj çështjeje në shkallët e gjyqësorit.

Prokuroria e rrethit gjyqësor Elbasan ka kthyer përgjigje¹⁵ duke bashkëlidhur kopje të njehsuar të akteve të fashikullit të procedimit penal nr. ***/2014.

Në këta fashikuj penal, si dhe në vendimet e gjykatave rrespektive, konstatohet se, kundër disa shtetasve duke përfshirë edhe denoncuesit D.D dhe K. H, ka ushtruar kallzim penal shoqëria “***” dhe mbi bazën e këtij kallzimi, Prokuroria Elbasan ka rregjistruar procedimin penal nr. ***, të vitit 2014. Për këta dy shtetas, prokuroria ka kërkuar të procedohen penalisht për kryerjen e veprës penale “Vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, sipas nenit 135 të K.Penal. Siç vihet re nga materiali hetimor, nga muaji korrik 2014 dhe deri më datë 26.3.2021 prokurorë të çështjes duket se, kanë qënë B.M. dhe K.J. Me vendimin e datës 26.3.2021 të drejtuesit të prokurorisë Elbasan, prokurori i çështjes z. B.M. zëvendësohet me prokurorin z. Xhelian Seferi.

Më datë 3.3.2022 në diskutimin e tij përfundimtar, prokurori Xh. Seferi kërkon deklarinimin fajtor të tre shtetasve, ndër këta dy denoncuesve në këtë denoncim të D.D dhe K. H dhe pushimin e gjykimit për një shtetas tjetër, për kryerjen e veprës penale “Vjedhjes së kryer duke shpërdoruar

¹⁴ Shih kërkesën e Komisionit drejtuar Prokurorisë Elbasan me nr. *** prot., datë 28.3.2023.

¹⁵ Shih shkresën me nr. *** prot., datë 5.4.2023 të Prokurorisë Elbasan.

detyrën” dhe dënimin përkatësisht më 1 vit burgim dhe 2 vite burgim për dy denoncuesit D.D. dhe K.H.

Duke ju kthyer edhe njëherë pretendimeve të denoncuesve për prokurorin Xh.Seferi, i cili, sipas tyre “*nuk i ka marrë parasysh provat e dala gjatë procesit civil të vitit 2019*” si dhe “*nuk ka dashur të njihet me kërkesat e të paditurve*”, Komisioni vlerësoi se, këto pretendime të denoncuesve nuk qëndrojnë për shkak se, është Gjykata ajo që shqyrton kërkesat e palëve në proces si dhe i jep atyre vlerë ligjore, duke i parë në harmoni me njëra tjetrën. Organi i akuzës, përkundrazi, bën hetimin e çështjes në lidhje me faktet e provat e rregjistruara nga një kallzim penal i inicjuar ose dhe kryesisht, në raport me misionin që organi i prokurorisë ka, atë të mbrojtjes së marrëdhënieve juridike në shërbim të qytetarëve.

Sa më sipër, nuk u evidentuan shkelje procedurale nga ana e prokurorit të çështjes në drejtim të ezaurimit të veprimeve të kryera nga ana e tij në drejtim të plotësimit të kërkesave të palëve në këtë procedim penal. Për këtë arsye, nuk mund të hetohej më tej për subjektin e rivlerësimit, për shkak se nuk u konkludua që ai të ketë kryer shkelje procedurale në dëm të interesave të këtyre shtetasve.

2. Denoncim i përsëritur i shtetasit H. G me nr. * prot., datë 26.11.2018 dhe nr. *** prot., datë 21.9.2020.**

Denoncuesi ankohet për shumë subjekte të tjerë, ndër to edhe për subjektin e rivlerësimit duke thënë se, prokurori Xh. Seferi ka mbyllur një çështje dhe tjetra dosje “fle”. Denoncuesi thotë se, dosja e zezë me 500 milionë lekë të vjetra është korrupsion i hapur dhe këtij korrupsioni i ka hapur rrugë Byroja e Sigurimeve të Shqipërisë.

Për të vlerësuar pretendimet e denoncuesit, Komisioni i është drejtuar ILD-së, me kërkesën për informim në lidhje me ecurinë dhe vendimmarrjen e ankesës së H.G ndaj z. Xhelian Seferi, prokuror pranë Prokurorisë së rrethit gjyqësor Elbasan.

Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2023 ILD ka kthyer përgjigje duke sqaruar se, për këto ankesa, me vendimin nr. *** prot., datë 26.4.2022 është vendosur “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të paraqitura nga shtetasi z. H.G”. Në këto kushte nuk mund të hetohej më tej për këtë denoncim.

3. Denoncim i përsëritur i shtetasës D.Xh me nr. * prot., datë 30.4.2018 dhe nr. *** prot., datë 2.10.2018.**

Denoncuesja ankohet për shumë subjekte të tjerë, ndër to edhe për subjektin e rivlerësimit prokurorin Xh. Seferi dhe konkretisht në pikën 6, faqe 10 e vijues të ankimit të parë (nr. *** prot.), si dhe ankimit të dytë (nr. *** prot.) duke thënë se, prokurori nuk hetoi për çështjen e saj, pavarësisht se sipas ankueses, ishte ajo që kishte mbledhë provat dhe ja kishte vënë në dispozicion organit të akuzës. Sipas denoncueses, -oficerët e policisë gjyqësore, prokurorët, avokatët, përfaqësuesit e shoqërisë së sigurimit S dhe gjyqtarët në bashkëpunim me njëri tjetrin, kanë manipuluar e falsifikuar provat dhe kanë dhënë një vendim kriminal duke bërë të mundur për të dytën herë “vrasjen nga padrejtësia”.

Bashkëlidhur dy denoncimeve (secili denoncim nga 13 faqe), ankuesja D.Xh ka sjellë aktet e prokurorive dhe gjykatave të cilat u analizuan nga Komisioni ku rezultoi:

Vendim mosfillimi procedimi penal datë 7.11.2016 i prokurorit F.L. në lidhje me kallëzimin penal të D.Xh (rregjistruar me nr. *** rregjistri) ndaj prokurores A.G. dhe OPGJ-së O.Gj. për veprën

penale “shpërdorim detyre”, për shkak se ajo ka qënë e njëanshme, ka marrë si provë dokumente të fallsifikuara, nuk ka marrë në pyetje dëshmitarët që kanë pasur dijeni për aksidentin e ndodhur më datë 16.10.2015, ku bashkëshorti i ankueses K.Xh. ka humbur jetën (si shkak i përplasjes së kamionit me drejtues J.A. me motorrin e drejtuar nga viktimja K.Xh.). Ankuesja të gjitha këto i ka pretenduar si shkelje procedurale të kryera nga prokurorja e çështjes dhe e ka ankimuar këtë vendim. Gjykata e rrethit gjyqësor Elbasan e ka pranuar ankimin e D.Xh duke prishur vendimin e datës 7.11.2016 të prokurorisë Elbasan dhe duke e urdhëruar këtë të fundit të vazhdojë veprimet për kallzimin e bërë nga ankuesja. Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan ka rregjistruar procedimin penal nr. *** të vitit 2017 për kryerjen e veprave penale “Falsifikim dokumenti” dhe “Shpërdorim detyre”. Ky rregjistrim është bërë duke u bazuar në vendimin nr. ***, datë 3.3.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, me të cilin është prishur vendimi “Mbi mosfillimin e procedimit penal”, datë 7.11.2016, nga ku dhe është urdhëruar vazhdimi i veprimeve për këtë kallzim nga prokuroria.

Në përfundim të hetimit për këto vepra penale prokurori F.L. vendos pushimin e hetimeve për procedimin penal nr. ***/2017 pasi fakti nuk përbën vepër penale. Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë Elbasan ka paraqitur ankim përpara Gjykatës së Apelit kundër vendimit nr. ***, datë 28.3.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me objekt kundërshtimin e vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit ***, të vitit 2017, me argumentimin se, kryerja e veprimeve të vendosura nga gjykata nuk mund të japin ndonjë të dhënë të re për përcaktimin e faktit penal dhe për pasojë të përgjegjësisë penale. Ky ankim i prokurorisë Elbasan është paraqitur nga prokurori z. Xhelian Seferi.

Në arsyetimin e fakteve dhe rrethanave që subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit pranë prokurorisë Elbasan i bën çështjes ka të bëjë me zgjidhjen në themel të saj dhe jo me shkelje procedurale të kryera nga ai apo ndonjë prokuror tjetër në çështjen në fjalë. Për këtë arsye nuk mund të hetohet më tej për këto denoncime të zonjës D.Xh. në adresë të subjektit të rivlerësimit.

4. Denoncim i shtetasit E.K me nr. * prot., datë 20.3.2019.**

Denoncuesi i kërkon Komisionit të hetojë prokurorin Xh. Seferi për shkak se, siç thotë ai, prej 8 muajsh mbahet në paraburgim me pa të drejtë, me prova të sajura për qëllime korruptive duke qënë dhe invalid.

Denoncuesi e mbyll denoncimin e tij me besim se kërkesa e tij të merret parsysh, pa evidentuar një “padrejtësi konkrete” apo procedim penal ku mund të hetohet për shkelje procedurale apo shkelje të tjera etike që kanë të bëjnë me punën e prokurorit z. Xh. Seferi.

5. Denoncim i shtetases L.C me nr. * prot., datë 17.9.2018.**

Denoncuesja denoncon prokurorin Xhelian Seferi: *për fshehje të vërtetës; se nuk ka kryer hetime të plota për të zbuluar autorët e vërtetë; nuk ka kryer procedurë të rregullt ligjore, por ka ngritur akuza pa pasur asnjë provë ndaj djalit të saj, bazuar vetëm në akuzën që ka ngritur i dëmtuari.* Denoncuesja vazhdon duke thënë se, i kanë kërkuar prokurorit të çështjes kryerjen e ekspertizës ligjore, por ai nuk e ka bërë, pasi fillimisht akuza ka qënë “plagosje e lehtë”, pastaj prokurori e ka rënduar në “plagosje e rëndë me dashje”.

Gjithashtu denoncuesja denoncon edhe subjekte të tjerë rivlerësimi për shkak se ata e kanë dënuar padrejtësisht djalin e saj.

Bashkëlidhur këtij denoncimi, gjendet vendimi nr. ***, datë 13.4.2016 i Gjykatës së rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesë Prokuroria, përfaqësuar nga prokurori Xh. Seferi si dhe vendimi nr. ***, datë 8.5.2017 i Gjykatës së Apelit Elbasan.

Organi i prokurorisë Elbasan, përfaqësuar nga prokurori z. Xhelian Seferi i është drejtuar Gjykatës së rrethit gjyqësor Elbasan me kërkesën: Vleftësim arresti, caktim mase sigurimi personal ndaj shtetasit D.C për shkak të ngjarjes së ndodhur më dt. 9.4.2016 ku D. C bashkë me shtetasin H. C. kanë goditur me grushte dhe sende të forta shtetasin A. P. Ky i fundit është ankuar në polici dhe për këtë organi i prokurorisë (pas rregjistrimit të procedimit penal) i është drejtuar gjykatës me kërkesën që të vleftësojë si të ligjshëm arrestimin e shtetasit D. C me akt motivimi, dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Plagosjes së lehtë me dashje”, kryer në bashkëpunim, duke kërkuar edhe caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në shtëpi”. Personi i dyshuar D.C, nëpërmjet avokatit të tij ka mohuar në mënyrë kategorike që të ketë goditur shtetasin A.P. natën e ngjarjes duke pretenduar se, natën e ngjarjes ai ka qënë tek shtëpia e gjyshit të tij. Ndërsa Gjykata, në lidhje me llojin e masës së sigurimit ka argumentuar se, për shkak se, vepra penale për të cilën dyshohet se ka kryer D.C, futet në seksionin e veprave penale që përbën kundravajtje penale, dispozitë që parashikon dënim me gjobë dhe me burgim deri në dy vjet, çka do të thotë se rëndësia e faktit, parë në raport me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete, nuk i përgjigjet nevojave të sigurimit që parashikon masa ekstreme e “arrestit”, ndonëse në kushtet e shtëpisë, si dhe duke parë se rrezikshmëria e personit nën hetim nuk është e tillë që ti përgjigjet nevojave të sigurimit që parashikon masa ekstreme e “arrestit”, vendos të caktojë masën “detyrim për tu paraqitur në Policinë Gjyqësore”.

Gjykata e Apelit me vendimin e saj ka dënuar personin D.C. për kryerjen e veprës penale “Plagosje e rëndë me dashje”, e kryer në bashkëpunim, dhe në bazë të nenit 88/1 e 25 të K.Penal dënimin e tij me 3 (tre) vite burgim.

Sa më sipër, duke parë argumentimin që sjell prokurori dhe arsyetimin e gjykatës në këto dy vendime, Komsioni del në konkluzionin se pretendimet e denoncueses (nënës së pandehurit D.C.) nuk qëndrojnë përse i përket procedurës së kryer nga ana e prokurorit të çështjes z. Xhelian Seferi e për këtë arsye nuk mund të hetohet më tej.

6. Denoncim anonim me nr. * prot., datë 23.7.2021.**

Denoncuesi anonim kërkon të inspektohet dosja e pushimit të çështjes mediatike të tregut elektrik, ku kriminelët kishin goditur makinën e shefit të policisë Elbasan. Gjithashtu denoncuesi evidenton një “fakt” rreth një ngjarje shumë sensitive për të cilën nuk jep të dhëna të mëtejshme e për të cilën Komisioni nuk mund të hetohet më tej.

Pavarsisht sa thuhet në denoncim, nuk citohet një akt, vendim apo proces gjyqësor konkret, që të mund të hetohet më tej.

7. Denoncim anonim me nr. *** prot., datë 14.11.2022.

Denoncuesja anonime thotë se, është punonjëse e gjykatës Elbasan dhe kërkon e shpreson se ONM të bëjë ndonjë hetim për shumë gjyqtarë e prokurorë të Elbasanit, duke përfshirë këtu edhe subjektin e rivlerësimit Xh. Seferi, me qëllim për të treguar “dështimin e reformës në drejtësi”.

Ajo ngre akuza të pavërtetueshme në lidhje me shumë subjekte rivlerësimi, të cilët akoma nuk i janë nënshtruar procesit të rivlerësimit.

Në kushtet kur denoncuesja nuk flet për një rrethanë apo situatë konkrete që ka të bëjë me shkelje të kryera nga prokurori Xhelian Seferi, Komisioni nuk mund të hetojë më tej.

E. TË TJERA

Nga indicie të mbërritura pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në lidhje me ushtrimin e funksionit si prokuror të subjektit të rivlerësimit Xhelian Seferi, Komisioni i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesën me nr.*** prot., datë 29.5.2023 për vënienë në dispozicion të kopjeve të praktikave të ndjekura nga subjekti Xhelian Seferi për çështjet:

1. Procedimin penal të vitit 2017 ndaj shtetasve F dhe H.Ç, për veprën penale “plagosje e rëndë në bashkëpunim”;
2. Procedimin penal të vitit 2021 ndaj shtetasit F.S, për veprën penale “plagosje e rëndë”;
3. Procedimin penal ndaj shtetasit S.S etj, të vitit 2019, për caktimin e masës së sigurisë;
4. Procedimin penal ndaj shtetasit M.D në vitin 2015 për veprën penale “vjedhje”;
5. Procedimin penal ndaj shtetasit R.A etj, për veprën penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve”.

Për këto çështje gjithashtu është kërkuar informacion për ecurinë e tyre në shkallët e gjyqësorit.

Prokuroria¹⁶ e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka dërguar pranë KPK-së informacionin e kërkuar, të cilat Komisioni i analizoi si vijon:

1. **Në lidhje me procedimin penal nr. ***, datë 8.4.2017 ndërmjet shtetasve: H.B (H, Ç), F.G (Ç) dhe vëllezërve e djalit të xhaxhait të tyre K.Gj. A.Gj dhe E.Gj.**

Rrethanat e çështjes: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në cilësinë e organit procedues kompetent ka rregjistruar procedimin penal në ngarkim të shtetasve vëllezër, H B (H, Ç), F.G (Ç) dhe vëllezërve e djalit të xhaxhait të tyre K.Gj, A.Gj e E.Gj në lidhje me ngjarjen e ndodhur në vendparkimin e restorant “****”, Elbasan ku ka patur përplasje fizike me armë zjarri. Prokuror i çështjes është caktuar z.N.H. Ndërsa në datën 27.7.2017 është bërë zëvendësimi i prokurorit N. H. me prokurorin D. G.

Çështja e cila po ndiqej nga prokurori N.H. kishte të bënte me hetimin për veprat penale, “vrasje me dashje”, e mbetur tentativë, e kryer në bashkëpunim dhe “mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit” të parashikuara nga nenet 76, në lidhje me nenin 22 dhe 25 dhe nenin 278 të K. Penal.

¹⁶ Me shkresën me nr. *** prot., datë 2.6.2023, me lëndë *Dërgohet informacioni i kërkuar.*

Më datë 28.7.2017 prokurori D.G. ka vendosur pushimin e ndjekjes penale në ngarkim të shtetasve A.Gj., F.G dhe E. Gj. në kuadrin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2017, për kryerjen e veprave penale, të parashikuara nga nenet 76-22-25 dhe 278/2 të K. Penal.

Më vendimin nr. ***, datë 11.10.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur: Deklarimin fajtor të pandehurit K.Gj. dhe H. B. për kryerjen e veprave penale “Plagosje e rëndë me dashje”, të kryera në dëm të njëri tjetrit; “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit” dhe “Futja ose mbajtja pa leje të sendeve të ndaluara në insitucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim”, të parashikuara nga nenet 88/1. 278/1 dhe 324/a të K.Penal dhe dënimin e tyre përfundimisht, përkatësisht me nga 4 vite burgim dhe në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për kohën e pavuajtur të dënimit dhe vënien e të pandehurve në provë për një periudhë për 4 vjet, me kusht që të pandehurit gjatë kohës së provës të mos kryejnë vepra të tjera penale.

Nga përgjigjja e organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan thuhet se, prokurori z. D. G. është zëvendësuar në gjykim nga prokurori z. Xhelian Seferi. Në fashikujt e procedimit penal nuk ka një dokument zëvendësimi, por evidentohet se në diskutimin përfundimtar dhe urdhërin për ekzekutimin e vendimit penal të datës 11.10.2017 e ka nënshkruar prokurori Xhelian Seferi.

Duket se, subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar ndjekjen penale nga fillimi i hetimit por çështjen e ka ndjekur në diskutimin përfundimtar që zhvillohej në Gjykatë.

Subjektit iu kërkua të paraqesë shpjegime për hapat procedural të ndjekur si dhe të paraqesë aktin e përfshirjes së tij në këtë çështje penale.

Në përgjigje të rezultateve të hetimet, subjekti ka shpjeguar se, *Prokuroria pranë Gjykatës Shkallës së Parë Elbasan mbi bazën e materialit referues të ardhur nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan më datë 8.4.2017 ka regjistruar procedimin penal nr. ***/2017 për veprat penale të “Vrasjes me dashje”, e mbetur në tentativë dhe e kryer në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 76 -22 dhe 25 dhe nenin 278 të K.Penal.*

Prokurori i çështjes fillimisht ka qënë z. N.H, i cili më pas është zëvendësuar me prokurorin D.G, i cili ka qenë prokurori që ka bërë njoftimet e akuzës, pushimin e hetimeve për disa persona nën hetim dhe kërkesen për dërgimin e çështjes për gjykim në ngarkim të të pandehurve K.Gj dhe H. B per t'u gjykuar nën akuzën e "Plagosjes së rëndë me dashje", "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit" dhe "Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit" parashikuar nga nenet 88/1, 278/1 dhe 324/a paragrafi / i K.Penal.

Në seancën gjyqësore të datës 27.9.2017 në Gjykatën e Shkallës se Parë Elbasan unë jam autorizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë z. D.G që të përfaqësoja akuzën që ishte dhe vetë prokuror i çështjes. Autorizimi është akt që qëndron në fashikullin e gjykimit dhe nga ana ime është depozituar në Gjykatë në seancë gjyqësore të datës 27.9.2017, ku nga Gjykata jam legjitimuar për të qënë palë në proces. Gjykimi ka vazhduar me procedurën e gjykimit të shkurtuar. Në datë 1.11.2017.

Në datë 11.10.2017 jam paraqitur në seancë gjyqësore përsëri me Autorizim të kësaj date, lëshuar nga Drejtuesi i Prokurorisë, ku kam parashtruar Diskutimin përfundimtar mbi këtë çështje duke kërkuar përfundimisht Deklarimin fajtor të të pandehurve (sipas dokumentit Diskutim përfundimtar).

*Gjykata e Shkallës së parë Elbasan me vendimin nr-*** (***) datë 11.10.2017 ka dhënë masa dënimi aq sa janë kërkuar nga Prokurori, por ka aplikuar nenin 59 të K. Penal duke vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të denimit me burgim për kohën e pavuajtur të dënimit dhe vënien e të pandehurit K.Gj.dhe H.B. në provë për një kohë prej 4 vitesh.*

*Në datë 24.10.2017 nga ana inne, si prokuror seance, duke mos qënë dakort me vendimin e mësipërm për sa i perket aplikimit të alternativës së denimit, është ushtruar ankim ndaj vendimit të mësipërm të Gjykatës duke kërkuar: Ndryshimin e vendimit gjyqësor nr. *** datë 11.10.2017 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.*

Vendimi i mësipërm është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe aktualisht dosja ndodhet në gjykim në Gjykatën e Lartë.

Bashkëlidhur ju vë në dispozicion autorizimet përkatëse të datave 27.9.2017 dhe 11.10.2017 të Drejtuesit të Prokurorisë Elbasan.

2. Në lidhje me procedimin penal nr. *, të vitit 2021 në ngarkim të shtetasit F.S, për veprën penale “plagosje e rëndë”.**

Rrethanat e çështjes: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka rregjistruar procedimin penal të vitit 2021, në lidhje me ngjarjen e ndodhur në 11.2.2021 ku shtetasi S.S është goditur me sende të forta nga shtetasi F. S.

Referimi i veprës penale është bërë nga ankimi që viktima S.S ka bërë pranë Komisarariatit të Policisë Elbasan. Procedimi penal është rregjistruar në ngarkim të shtetasit F.S dyshuar për kryerjen e veprës penale “Plagosje e rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88/1 i K. Penal. Dëmtimet kanë qënë të tilla që viktima është dashur të mjekohet në spitalin kirurgjik Elbasan dhe sipas aktit të ekspertimit mjeko-ligjor dëmtimet e shkaktuara hynin në dëmtimet mbi 9 ditë.

Viktima fillimisht ka shpjeguar se kërkon ndjekje ligjore për shtetasin F.S. Pasi viktima është njohur me akt ekspertimit nr.***, datë 22.2.2021 ka kërkuar riekspertim pasi ka pretenduar se, dëmtimet e marra janë të rënda. Viktima është thirrur sërish dhe pasi është njohur me akt e riekspertimit nr. *** datë 19.5.2021 ka bërë tërheqje nga ankimi, sipas procesverbalit të mbajtur më datë 27.5.2021 për shkak se, nuk dëshironte që çështja të shkonte për gjykim, duke qënë se marrëdhëniet me shtetasin nën hetim F.S. ishin normalizuar dhe se ai kishte probleme serioze shëndetsore dhe nuk donte që çështja të vazhdonte më tej.

Prokurori i çështjes me urdhërin e datës 1.6.2021 ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale, nga “Plagosje e rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88/1, duke vazhduar hetimet për veprën penale të “Plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i K.Penal. Ankuesi e ka tërhequr ankimin në bazë të nenit 286 të K. Pr. Penale dhe prokuroria ka dalë në konkluzionin se, ekzistojnë rrethana ligjore të cilat nuk lejojnë vazhdimin e hetimeve për këtë procedim penal. Në këto kushte bazuar në nenin 328/1, gërma “c” të K. Pr. Penale, prokuroria ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***/2021 për personin nën hetim F. S. rregjistruar për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i K. Penal, për shkak se viktima ka tërhequr ankimin. Referuar dispozitës 89 të K.Penal përcaktohet se, *Plagosja e kryer me dashje, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.*

Referuar nenit 286 të K. Pr. Penale, ku shprehimisht thuhet se, - *Tërheqja e ankimit bëhet personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit me deklaratë të paraqitur në organin që procedon. Tërheqja e ankimit mund të bëhet në çdo fazë të procedimit, gjersa vendimi i gjykatës nuk ka marrë formën e prerë...*, duket se, prokurori ka zbatuar në mënyrë korrekte këtë dispozitë, përse i takon formës së tërheqjes së ankimit.

Konstatime të Komisionit:

Subjekti Xhelian Seferi ka bërë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale (nga regjistrimi fillestar i saj si “plagosje e rëndë me dashje” në “plagosje të lehte me dashje”) duke krijuar në dukje kushte për lehtësimin e pozitës së të pandehurit.

Ky ndryshim duket se është bërë nga subjekti pas përgjigjes së riekspertimit mjeko-ligjor, bërë me kërkesën e viktimës S.S (bazuar në pretendimin që dëmtimet e marra janë të rënda) dhe tërheqjes nga ankimi të viktimës. Nga ndryshimi i cilësimit të veprës penale në plagosje e lehtë me dashje është mundësuar dhe pushimi i gjykimit të çështjes. Nga verifikimi i dy aktekspertimeve nuk konstatohen ndryshime të mëdha midis tyre.

Kërkesa e të dëmtuarit për heqjen dorë është bërë sipas procesverbalit të datës 27.5.2021. Në këtë proces verbal i dëmtuari ka deklaruar se, “nga dëmtimet e marra pretendoj për plagosje të rëndë” por kam vendosur që ta fal shtetasin F.S dhe për këtë arsye dëshiroj të tërheq ankimin ndaj tij. Heqja dorë e viktimës është bërë në momentin procedural kur hetimi dhe komunikimi për palët ishte në cilësinë e veprës penale “plagosje e rëndë me dashje” dhe në këto kushte dhe rrethana nuk mund të vendosej pushimi i gjykimit edhe pas heqjes dorë të viktimës. Më pas më datë 1.6.2021 subjekti i rivlerësimit ka bërë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale në “plagosje e lehtë me dashje” disa ditë pas tërheqjes nga ankimi të viktimës.

Në urdhërin për ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale të datës 1.6.2021 subjekti Seferi ka argumentuar se, bazuar në tërheqjen e ankimit të bërë nuk jemi para veprës penale të “plagosje e rëndë me dashje” por jemi para veprës penale “plagosje e lehtë me dashje” dhe në këto rrethana duhet të bëhet ndryshimi i cilësimit juridik i veprës penale, pa argumentuar ligjërisht shkaqet e ndryshimit.

Për sa më sipër, referuar këtyre konstatimeve Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit iu të jepte shpjegime në përputhje me nenin 52 të ligjit 84/2016.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se, *Prokuroria pranë Gjykatës Shkallës së Parë Elbasan mbi bazën e materialit referues të ardhur nga Komisariati i Policisë Elbasan ka regjistruar më datë 16.2.2021 procedimin penal nr. ***/2021 me person nën hetim F.S. Për hetimin e këtij materiali jam caktuar me short elektronik. Sipas akteve të fashikullit me datë 11.2.2021 rreth orës 7:30 është marrë njoftim se shtetasi S.S është goditur me sende te forta ne banesën e tij në lagjen “***”, Elbasan. Më pas ky shtetas ishte dërguar për mjekim në Spitalin Kirurgjik Elbasan. Është përpiluar vendimi i ekspertimit mjeko-ligjor për shtetasin S. S.*

*Është administruar akti i ekspertimit mjeko-ligjor për shtetasin me nr.***, datë 22.2.2023 ku është konkluduar se dëmtimet e shkaktuara shtetasit S.S hyjnë në kategorinë e dëmtimeve mbi 9 ditë.*

Me aktin e ekspertimit është njohur viktimë/kallëzuesi kundrejt nënshkrimit, dhe me Memo ka kërkuar kryerjen e një akti tjetër ekspertimi pasi nuk ka qënë dakort me konkluzionin.

*Nga ana ime si Prokuror i çështjes është pranuar kërkesa dhe për një zgjidhje sa më të drejtë të kategorizimit të dëmtimeve është vendosur kryerja e riekspertimit mjeko-ligjor të viktimës Seit Skënderi me grup ekspertesh të IML Tiranë. Është administruar akti i riekspertimit mjeko-ligjor nr.*** dt 19.05.2021, administruar në datë 24.05.2021 ku dëmtimet e konstatuara janë po ato si të aktit të parë dhe kategorizimi është plagosje e lehtë. Është njohur viktimia me aktin e riekspertimit, i është marrë deklaram dhe ka deklaruar se tërheq ankimin e bërë. Për këtë fakt konform dispozitave ligjore procedurale i është mbajtur procesverbal për tërheqjen e ankimit dt.27.05.2023 ora 10:30 nga OPGJ i dosjes. Në datë 31.05.2021 nga Oficeri i Policisë Gjyqësore i deleguar me kryerjen e veprimeve hetimore është përpliluar relacion përfundimtar bazuar në nenin 326 të K.Pr. Penale është sygjëruar pushimi i hetimeve. Me marrjen fizikisht nga ana ime të fashikullit të procedimit penal nr. ***/2021 në datë 1.6.2021 kam urdhëruar për ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale duke bërë zyra e regjistrat dhe ndryshimet në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Këtë Urdhër për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës e kam bazuar në nenin 287/2 të K.Pr-Penale. Pra, unë jam i detyruar me ligj që të disponoj në momentin që ndryshon cilësimi juridik apo një rrethanë e veprës penale. E kundërta do të ishte shkelje e procedurës por edhe e të drejtave të personit nën hetim, i cili sipas hetimeve deri më datë 1.6.2021 me veprimet e tij viktimës i kishte shkaktuar plagosje të lehtë, ndaj nuk mund të vazhdohej më si person nën hetim për veprën penale të "Plagosje e rëndë".*

Në asnjë moment me këte vendimmarrje nuk kam krijuar kushte për lehtësimin e pozitës së personit nën hetim, përkundrazi kam respektuar dispozitat ligjore, të drejtat e personit nën hetim dhe të viktimës në proces penal.

*Më datë 25.6.2021 palëve ju është komunikuar përfundimi i hetimeve dhe në datë 12.7.2021 është vendosur pushimi i hetimeve të procedimit penal nr.***, viti 2021. Vepra penale e "Plagosje e lehtë me dashje", parashikuar në nenin 89 të Kodit Penal është veprë e cila në bazë të nenit 284 të K.Pr.Penale ndiqet vetëm me ankimin e dëmtuarit, i cili mund ta tërheqë atë çdo fazë të procedimit. Kallëzuesi ka tërhequr ankimin në bazë të nenit 286 të K.Pr.Penale. Në këto kushte, kur është tërhequr ankimi i të dëmtuarit duhet të vendoset pushimi i procedimit penal, referuar nenit 328/1/c të K.Pr.Penale.*

3. Në lidhje me procedimin penal ndaj shtetasit S.S etj, të vitit 2019, për caktimin e masës së sigurisë.

Rrethanat e çështjes: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. *** të vitit 2019, për ngjarjen e ndodhur, një konflikt, në lagjen "****", Elbasan referuar ankimit të shtetasit A.C ndaj shtetasve S.S, E.S dhe A. F me prokuror të çështjes subjektin e rivlerësimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan i ka gjykuar të pandehurit për veprën penale "Plagosje e lehtë me dashje", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 89 dhe 25 i Kodit Penal dhe me vendimin nr. ***, datë 17.2.2020 ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit, miratimin e urdhërit penal datë 31.1.2020 me anë të cilit është disponuar *Deklarimi fajtor i të pandehurve duke i gjobitur përkatësisht: S.S me 50,000 dhe E. S. dhe A. F. me nga 100,000 lekë.*

Referuar ankimit penal të paraqitur nga shtetasit S. S etj, më datë 4.3.2020, me objekt ankim ndaj vendimit nr. ***, datë 17.2.2020 të Gjykatës së Shkallës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, referuar nenit 406/ç dhe nenit 284 të K.Pr.Penale, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan është shprehur me vendimin nr. ***, datë 10.3.2021, ku ka vendosur "*Pushimin e gjykimit të çështjes për shkak të*

*heqjes dorë nga ankimi për ushtrimin e ndjekjes penale nga ana e viktimës” (rreth një vit më vonë nga vendimi ***, datë 17.2.2020)*

Konstatohet se, këta shtetas i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan e cila ishte shprehur një herë me vendim por jo Gjykatës së Apelit, si gjykata kompetente që shqyrton ankimin e palëve (Neni 406 i K.Pr.Penale).

Në vendimin ***, datë 10.3.2021 me gjyqtar T. K. referuar palëve në gjykim, vihet re, prokurori ka kërkuar të pranohet heqja dorë nga viktimia. Por subjekti Seferi duhet të ngrinte pretendimin dhe kundërshtimin e procedurës së gjykimit nga kjo gjykatë për arsye se, po kjo gjykatë ka pranuar kërkesën e prokurorit për miratimin e urdhërit penal me disponimin e dënimit të pandehurve me gjobë në vlerat e përkatëse. Heqja dorë e viktimës nga ankimi është bërë pas dhënies së vendimit nga Gjykata e Rrethit Elbasan dhe kjo kërkesë duhet të trajtohej së bashku me ankimin në Gjykatën e Apelit.

Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kërkuar të jepte shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se, *Prokuroria pranë Gjykatës Shkallës së Parë Elbasan mbi bazën e materialit kallëzues të ardhur nga Komisariati i Policisë Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. ***/ 2019 për veprën penale të “Plagosja e lehtë me dashje”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 89-25 i K. Penal në ngarkim të të pandehurve E.S., A.F. dhe S.S.*

Në përfundim të hetimit nga unë si Prokuror i çështjes është disponuar me Urdhër Penal dt.31.01.2020, bazuar në nenin 406/a të K.Pr.Penale duke vendosur: Dënimin e të pandehurit S. S. me xxx lekë gjobë; Dënimin e E.S. me xx lekë gjobë; Dënimin e A.F. me xx lekë gjobë....etj. Këto urdhëra penale më kërkesat e datës 31.01.2020 i janë drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për miratim.

Neni 406/a i K.Penal ndër të tjera parashikon se: Kur i pandehuri akuzohet për kryerjen e kundërvajtjeje penale brenda tre muajve nga regjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale prokurori nxjerr urdhër penal të arsyetuar për caktimin e dënimit dhe i kërkon gjykatës miratimin e tij në rastet kur e çmon se nuk duhet të zbatohet dënimi me burgim. Në urdhrin penal prokurori cakton dënimin kryesor me gjobë ...

Gjykata sipas nenit 406/b e shqyrton kërkesën në dhomë këshillimi pa praninë e palëve. Në rastin konkret gjykata në dhomë këshillimi ka pranuar kërkesën e prokurorit për miratim urdhri penal.

Vendimi i Gjykatës i njoftohet palëve të cilët kanë të drejtë ta kundërshtojnë atë tek e njëjta gjykatë, brenda dhjetë ditëve nga marrja dijeni. Kjo rezulton sipas nenit 406/ç të K.Pr.Penal, pra ankim kundërshtues ndaj vendimit të gjykatës që miraton urdhrin penal bëhet tek e njëjta gjykatë. Në rastin konkret të pandehurit kanë kundërshtuar në Gjykatën e Shkallës së Parë Elbasan vendimin që miraton urdhrin penal.

Po sipas nenit 406/ç, paragrafi 3, Gjykata kur ka kundërshtim, cakton datën e gjykimit dhe njofton palët. Pra sipas ligjit fillon gjykimi në gjykatën e Shkallës së Parë, gjykim që mund të jetë i zakonshëm apo i shkurtuar. Kështu është vepruar nga Gjykata dhe në rastin konkret, ndaj unë si përfaqësues i akuzës në gjykim, kam parashtruar faktin penal dhe akuzën ndaj të pandehurve.

Në gjykim është paraqitur viktimia nga vepra penale shtetasi A. Ç., i cili ka tërhequr ankimin. Sipas ligjit ankimi mund të tërhiqet në çdo gjendje dhe shkallë gjykimi derisa vendimi të mos

ketë marrë formë të prerë. Fakti i zgjatjes së gjykimin gati një vit nuk është për shkaqe që varen nga unë si palë në proces. Prandaj në seancë gjyqësore është mbajtur qëndrim se tërheqia e ankimit ishte sipas ligjit dhe ajo duhet të pranohet nga Gjykata dhe se procedura e ndjekur nga Gjykata për mua si Prokuror është konform procedurës.

Pas konsiderimit të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me tre çështjet e sipërcituara, Komisioni arrin në përfundimin se, ato ishin bindëse dhe shterruese dhe se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit ka kryer detyrat e tij funksionale në përputhje me ligjin procedural e material penal.

4. Në lidhje me procedimin penal ndaj shtetasit M.D në vitin 2015 për veprën penale “vjedhje”.

Rrethanat e çështjes: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka rregjistruar procedimin penal nr. ***, datë 5.5.2015 lidhur me ngjarjen e ndodhur në një lagje të qytetit Elbasan, ku i\ mituri M. D. ka vjedhur një sasi lekësh shtetasit K.Ll.

I mituri M.D. është akuzuar për veprën penale të “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134/1 i K. Penal. Prokurori i çështjes, subjekti i rivlerësimit në përfundim të hetimeve i ka kërkuar Gjykatës Elbasan gjykimin e çështjes penale në ngarkim të M.D., parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal.

Edhe më parë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr.***, datë 7.1.2013, në referim të nenit 134/2 e 51 të K.Penal e ka dënuar të miturin M.D me 2 muaj burgim. Në bazë të nenit 59 të K.P pezullimin e dënimit me burgim dhe vënien në provë për të pandehurin për një periudhë prej 18 muajsh duke aplikuar edhe detyrimet e të dënuarit të vënë në provë, sipas nenit 60 të K.Penal. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 17.1.2013.

Ndërsa në lidhje me procedimin penal të vitit 2015, nuk kemi vendim të gjykatës bashkëlidhur listës së materialeve të fashikullit hetimor, por dokumentin *-Konkluzione përfundimtare të prokurorit drejtuar Gjykatës Elbasan*, i cili ka kërkuar deklarinim fajtor të të pandehurit M. D. sipas nenit 134/1 e 51 të K.Penal me 1 vit e 6 muaj burgim dhe në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale dënimin e tij përfundimisht me 1 vit burgim. Nga informacioni i Prokurorisë Elbasan, Gjykata e rrethit Gjyqësor me vendimin nr. ***, datë 24.7.2015 ka vendosur dënimin e tij përfundimisht me 1 vit burgim.

Nuk u konstatuan problematika në lidhje me kryerjen e veprimeve procedurale të prokurorit të çështjes për këtë procedim penal.

5. Në lidhje me procedimin penal ndaj shtetasit R.A etj, për veprën penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve”.

Rrethanat e çështjes: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka rregjistruar procedimin penal nr. ***, datë 16.11.2015, në ngarkim të shtetasve G.D, R.A dhe A.U për veprën penale “Prodhim dhe shitje narkotikësh”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i K. Penal. Prokurori i çështjes është caktuar z. Xhelian Seferi. Në kuadër të kryerjes së veprimeve për ushtrimin e

ndjekjes penale, evidentohet se, më datë 16.11.2015 ka nxjerrë urdhërin për regjistrimin e procedimit penal dhe emrit të personit që i atribuohet vepra penale, sipas materialit referues të datës 15.11.2015, të ardhur punonjësit e policisë.

Duket se, prokurori ka kryer një sërë veprimesh hetimore deri më datë 29.1.2016, kur ai paraqet kërkesë për heqje dorë dhe zëvendësimin e prokurorit për shkak se, ndaj tij si prokuror është bërë kallzim penal në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, Tiranë nga shtetasi H.D, babai i njërit prej personave nën hetim G.D. Drejtuesi i Prokurorisë Elbasan e ka pranuar këtë kërkesë më arsyetimin se, shkak i parashtruar nga prokurori për heqjen dorë nga hetimi i këtij procedimi penal është i bazuar në ligj sepse përbën shkak për të ngritur pretendime mbi paanshmërinë e tij. Këtë çështje më pas e ka vazhduar prokurorja E. T.

Në këto kushte nuk mund të diskutohej për evidentim shkeljesh proceduriale në këtë procedim penal nga ana e prokurorit Xhelian Seferi.

Vlerësimi i Komisionit për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit:

Në përfundim, Komisioni vlerësoi se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv dhe konsiderohet “i aftë”, duke arritur në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim të germës c, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Xhelian Seferi, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, referuar germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

- 1.** Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Xhelian Seferi, me detyrë Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
- 2.** Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
- 3.** Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
- 4.** Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 14.7.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta TAFA (BUNGO)
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Suela Zhegu
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi